

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

**RAPORT**  
**I**  
**AVOKATIT TË POPULLIT**

**Ex officio nr. 422/2021**

**Drejtësia Transicionale dhe zbatimi i mekanizmave të saj**

**Drejtuar:**

- Znj. Vjosa Osmani, presidente e Republikës së Kosovës
- Z. Glauk Konjufca, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
- Z. Albin Kurti, kryeministër i Republikës së Kosovës
- Znj. Albulena Haxhiu, ministre e Ministrisë së Drejtësisë
- Z. Hajrulla Çeku, ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit
- Z. Xhelal Sveçla, ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Z. Blerim Isufaj, kryeprokuror i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës
- Z. Albert Zogaj, kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës
- Z. Andin Hoti, kryesues i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur
- Z. Bislim Zogaj, drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
- Z. Enver Fejzullahu, drejtor ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë
- Kopjet: Z. Hëbit Hajredini, drejtor, Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 5 qershor 2023

## Tabela e përmbajtjes:

Hyrje .....	3
Drejtësia Tranzicionale dhe mekanizmat e saj.....	3
Proceset që i paraprinë luftës në Kosovë dhe pasojat e saj.....	4
Baza ligjore dhe kompetenca e Avokatit të Popullit.....	6
Përmbajtja dhe synimi i këtij raporti.....	7
Historik i shkurtër mbi Drejtësinë Tranzicionale .....	7
Instrumentet ndërkombëtare që parashikojnë dhe rregullojnë zbatimin e mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale .....	8
Pasqyrë e shkurtër e zbatimit të mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale në vende të tjera .....	11
Zbatimi në praktikë i mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale në Kosovë.....	13
E drejta për drejtësi .....	15
E drejta për të ditur .....	21
E drejta në reparacion .....	27
Garantimi i mospërsëritjes .....	33
Konstatimet dhe rekomandimet .....	36
Konstatimet.....	36
Rekomandimet .....	38

## Hyrje

Qëllimi i këtij raporti është të analizohet nga perspektiva e të drejtave të njeriut se a kanë qenë shteti dhe institucionet kompetente të Republikës së Kosovës në nivelin e përmbushjes së detyrimeve që dalin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nga ligjet në fuqi dhe nga instrumentet ndërkombëtare, për sa u përket krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë dhe sigurimit të drejtësisë për viktimat e këtyre krimeve.

Ky raport do të analizojë se sa ka arritur shteti t'i përmbushte mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale, siç janë: obligimet e shtetit karshi viktimave në ofrimin e drejtësisë për krime që janë kryer kundër tyre; se a ka arritur shteti ta përmbushte obligimin e vet në tërësi ndaj viktimave kur bëhet fjalë për mbledhjen dhe dokumentimin e fakteve mbi krimet e luftës; dhe a është përmbushur e drejta për të ditur. Gjithashtu do të vlerësohet se a ka arritur shteti t'i përmbushte detyrimet e veta për ofrimin e reparacioneve materiale ndaj viktimave dhe të së drejtës për mospërsëritje.

## Drejtësia Tranzicionale dhe mekanizmat e saj

Drejtësia Tranzicionale është një fushë relativisht e re. Përkundër faktit se Drejtësia Tranzicionale si koncept përdoret në të vërtetë vetëm për disa dekada, tashmë ekziston një kuptim shumë normativ i asaj që përfshin ajo. Mirëpo, pavarësisht gamës së aktiviteteve në nivel global dhe debatit akademik mbi këtë temë, fusha e Drejtësisë Tranzicionale konsiderohet se karakterizohet nga një mungesë relative e kornizës teorike. Diskursi dhe praktika e Drejtësisë Tranzicionale në fakt bazohen kryesisht në supozime të nënkuptuara rreth tranzicionit dhe/ose drejtësisë që janë ndikuar dhe formuar fuqishëm nga përvoja të veçanta historike, si ato pas Luftës së Dytë Botërore (grykimet e Nurembergut dhe të Tokios), tranzicioni i vendeve të Amerikës së Jugut nga diktatura në demokraci, gjykatat ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe Ruandën, ose Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimin (TRC) në Afrikën e Jugut.<sup>1</sup>

Në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, në vitin 2004, raport i cili i referohet Sundimit të Ligjit dhe Drejtësisë Tranzicionale në konflikt dhe pas konfliktit, Drejtësinë Tranzicionale e definoi si: *“Spektër i plotë i proceseve dhe i mekanizmave që lidhen me përpjekjet e një shoqërie për t'u pajtuar me një trashëgimi të abuzimeve në shkallë të gjerë në të kaluarën për të garantuar llogaridhënie, për të siguruar drejtësinë dhe arritjen e pajtimin.”*<sup>2</sup>

Drejtësia Tranzicionale ka për “detyrë” të ndihmojë një shoqëri pas konfliktit që të sigurojë drejtësi për viktimat dhe njohjen e tyre, ta rrisë besimin e qytetarëve në institucionet e shtetit, ta sigurojë respektimin e të drejtëve të njeriut, ta promovojë sundimin e ligjit dhe përmes këtyre masave t'i parandalojë shkeljet masive të të drejtave të njeriut në të ardhmen dhe ta nxisë pajtimin.

Ekzistojnë katër mekanizma kryesorë, të cilët mundësojnë arritjen e këtyre objektivave të Drejtësisë Tranzicionale:

- E drejta në drejtësi,

---

<sup>1</sup> <https://www.corteidh.or.cr/tablas/r32526.pdf>

<sup>2</sup> <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N04/395/29/PDF/N0439529.pdf?OpenElement>

- E drejta për të ditur,
- E drejta në reparacion,
- Garantimi i mospërsëritjes.

Këta mekanizma nuk duhet të shihen si zëvendësim i njëri-tjetrit, por duhet të ndërveprojnë me njëri-tjetrin.

### **Proceset që i paraprinë luftës në Kosovë dhe pasojat e saj**

Që nga viti 1974 Kosova fitoi autonominë e plotë dhe mori të drejta dhe kompetenca të plota sikurse edhe republikat e tjera në Jugosllavinë e atëhershme. Me ardhjen në pushtet të Slllobodan Millosheviqit në Serbi, ai filloi të ndërmernte veprime për suprimimin e autonomisë së Kosovës. Shqiptarët e Kosovës shprehën pakënaqësinë e tyre në demonstrata masive në fillim të marsit të vitit 1989, të cilat pastaj u përdorën si pretekst nga regjimi i Millosheviqit për të shpallur gjendje të jashtëzakonshme. Nën kërcënimin për përdorimin e forcës policore dhe ushtarake, më 23 mars Kuvendi i Kosovës votoi ndryshimet kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Republikës së Serbisë dhe me këtë Kosovës iu suprimua autonomia. Kjo nuk u pranua nga popullata shumicë në Kosovë dhe u përcoll me protesta të vazhdueshme. Gjithashtu, edhe deputetët e atëhershëm të Kuvendit të Kosovës nuk u pajtuan me këtë dhe nxorën Deklaratën Kushtetuese të 2 Korrikut 1990, me të cilën shpallën Kosovën republikë. Megjithatë, pushteti serb nuk i njohu këto akte të Kuvendit të Kosovës dhe filloi përndjekjen e deputetëve. Nga kjo periudhë Republika e Serbisë në mënyrë permanente ndërmori veprime me qëllim të ushtrimit të segregacionit dhe aparteidit të hapur kundër shqiptarëve në Kosovë. Shumica dërmuese e shqiptarëve u larguan nga administrata, nga policia dhe nga të gjitha shërbimet e tjera publike. Nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët nuk u lejuan t'i vijonin studimet në objektet shkollore dhe as në ndërtesat e Universiteti të Prishtinës. Në këto rrethana shqiptarët e Kosovës u detyruan ta organizonin jetën në sistem paralel, duke përfshirë organizimin politik, edukimin dhe shëndetësinë. Ndërkohë luftërat në Kroaci dhe në Bosnje e Hercegovinë kishin filluar dhe në të njëjtën kohë vazhdonte represioni kundër shqiptarëve të Kosovës. Ndërsa me përfundimin e luftërave në këto dy vende, në vitin 1995, represioni ndaj shqiptarëve u shtua, duke përfshirë edhe vrasjet. Në këto rrethana u krijua Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), si opsion i vetëm i mbetur për t'i bërë rezistencë represionit të Institucioneve Serbe në Kosovë. Lufta mes UÇK-së, nga njëra anë, dhe e forcave policore, ushtarak dhe paraushtarak të Serbisë, në anën tjetër, filloi në shkurt të vitit 1998 dhe përfundoi më 10 qershor 1999, pas përfshirjes së NATO-s, më 24 mars të vitit 1999.

Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta zyrtare për numrin e viktimave dhe të shkeljeve të rënda të drejtave të njeriut të kryera gjatë luftës në Kosovë, pikërisht për mungesën e mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale, ka të dhëna joformale të mbledhura nga ana e shoqërisë civile, e individëve dhe e organizatave të ndryshëm vendore dhe ndërkombëtare, që flasin për krimet masive dhe sistematike të kryera gjatë luftës në Kosovë. Sipas të dhënave nga Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (KNPZ), menjëherë pas luftës kanë qenë të raportuar rreth 4 500 persona të zhdukur nga lufta e Kosovës.<sup>3</sup> Ndërsa lista e parë me emrat e të

<sup>3</sup> “Raporti i ICPM-së - Vlerësimi i Gjendjes në Kosovë”, i qasshëm në: <https://www.icmp.int/wp-content/uploads/2019/03/May-2021-Albanian.pdf>.

zhdukurve gjatë viteve 1998, 1999 dhe deri në maj të vitit 2000, e publikuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, përmbante 3 368 emra<sup>4</sup> të personave të zhdukur.

Vlen të theksohet se nga viti 2001 deri në vitin 2021, në varrezat masive në territorin e Serbisë janë gjetur 950 trupa të personave që janë zhdukur në Kosovë, konkretisht 744 në Batajnicë, 84 pranë liqenit në Peruqac, 61 në Petrovo Selo, 52 në Rudnicë dhe 9 në Kizhevak. Në gusht të vitit 2022 llogariten të jenë 1 618 persona që ende nuk janë gjetur dhe për fatin e të cilëve ende nuk dihet.

Në përgjithësi, sipas të dhënave preliminare nga “Libër Kujtimi i Kosovës”, në lidhje me luftën në Kosovë, nga 1 janari i vitit 1998 e deri më 31 dhjetor të vitit 2000 janë vrarë apo zhdukur 13 535 persona.<sup>5</sup> Sipas të dhënave të këtij projekti, nga numri i përgjithshëm i të vrarëve dhe i të zhdukurve, janë mbi 10 000 civilë, prej të cilëve 1 133 janë fëmijë të vrarë apo të zhdukur në këtë periudhë.

Nga ana tjetër, sipas të dhënave të pakonfirmuara, supozohet se gjatë luftës në Kosovë rreth 20 000 persona kanë qenë viktimat e dhunës seksuale. Kjo shifër, përveç nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, është deklaruar edhe nga përfaqësuesit më të lartë të shtetit, duke përfshirë ish-presidentin, znj. Atifete Jahjaga.<sup>6</sup> Kryetarja e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës, gjatë raportimit në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione, deklaroi se deri më 28 mars 2023, Komisioni ka pranuar 1 939 aplikacione, prej të cilave janë trajtuar 1 881 dhe 58 janë në shqyrtim dhe se deri më tani janë aprovuar afro 1 473 aplikacione.<sup>7</sup>

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me partnerët e saj, janë duke i dokumentuar viktimat e dhunës seksuale dhe deri në fund të vitit 2022 kanë dokumentuar 1 060 raste të dhunës seksuale gjatë luftës. Për shkak të natyrës së këtyre krimeve dhe stigmës që i ndjek këto viktimat, shumica e tyre asnjëherë nuk do t’i paraqesin rastet dhe ato do të mbesin të paevidentuara.

Një numër shumë i madh i personave kanë qenë të plagosur me armë zjarri gjatë luftës, viktimat e trajtimit çnjerëzor apo viktimat e torturimit, si dhe kanë qenë subjekt i trajtimit çnjerëzor gjatë arrestimit dhe mbajtjes nga ana e policisë serbe. Mbi 2 000 prej tyre janë dërguar në mbajtje në burgjet në Serbi deri më 10 qershor 1999 dhe keqtrajtimi i tyre ka vazhduar deri në lirim të tyre nga burgjet. Duhet të theksohet se rreth 400 nga të burgosurit që janë mbajtur në burgjet serbe pas qershorit 1999 kanë qenë të mitur.

Mbajtja e civilëve si pengje në kampe të ndryshme dhe puna e detyruar gjithashtu kanë qenë ndër krimet e kryera nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë. Edhe pse, për fat të keq, nuk ka pasur një dokumentim sistematik të këtyre shkeljeve, misioni verifikues i OSBE-së, në

---

<sup>4</sup> <https://reliefweb.int/report/serbia/yugoslaviakosovo-icrc-publishes-book-missing>

<sup>5</sup> Paraqitja grafike e hulumtimit të “Librit të Kujtimeve të Kosovës”: Paraqitja grafike\_e\_hulumtimit\_LKK.pdf (kosovskaknjigapamcenja.org)

<sup>6</sup> Radio Evropa e Lirë: “Për 20 mijë gra të dhunuara, asnjë i dënuar”. Publikuar më 25.9.2012. E qasshme në: <https://www.evropaelire.org/a/24780862.html>

<sup>7</sup> <https://www.gazetaexpress.com/1402-grave-dhe-71-burrave-u-aprovohet-statusi-i-personave-te-dhunuar-gjate-luftes/>

raportin e vet “As Seen as Told”<sup>8</sup> ka përmendur disa raste të punës së detyrueshme, dhe atë në komunën e Suharekës, në fshatin “Fshati i Vjetër (Staro Selo); në komunën e Ferizajt dhe në një vend tjetër të paidentifikuar. Edhe Human Rights Watch, në raportin e vet: “Nën Pushtetit e Urdhrave” (Under the Orders), i ka identifikuar së paku dy raste ku të ndaluarit civilë shqiptarë janë dërguar në vende që kanë funksionuar si kampe pune, njëri në komunën e Gllogocit dhe tjetri në qytetin e Prizrenit: “*Rasti më i bujshëm ngjau në komunën e Gllogocit gjatë majit e qershorit 1999. Human Rights Watch dokumentoi gjithashtu punën e detyrueshme të të paraburgosurve në komunën e Prizrenit gjatë prillit të vitit 1999, ku të paktën në dy raste, policët serbë e ushtarët jugosllavë i mblodhën burrat në qytetin e Prizrenit, i hipën nëpër makina e i çuan në kufirin shqiptar, ku ata u vunë në shërbim të brigadave të hapjes së transheve. Ka gjithashtu dëshmi për brigada të punës në Rahovec, Suharekë e Gjakovë, ku në muajin prill 1999, romët u shtrënguan të hapnin transhe pranë kufirit me Shqipërinë.*”<sup>9</sup>

Sipas të dhënave të UNICEF-it, së paku 810 000 qytetarë të Kosovës gjatë luftës kanë qenë refugjatë në Shqipëri, në Maqedoni, në Mal të Zi, në Bosnjë e Hercegovinë dhe në vendet e tjera, ndërsa deri në tetor 1999, 130 000 të tjerë ishin larguar për në Serbi dhe në Mal të Zi.<sup>10</sup>

Përpos humbjeve në njerëz dhe krimeve të rënda kundër popullatës civile, gjatë luftës në Kosovë kanë ndodhur dëme të jashtëzakonshme materiale, duke përfshirë: plaçkitje, dëmtim apo shkatërrim të plotë të objekteve të banimit dhe të bizneseve publike dhe private. Vetëm shtëpi të shkatërruara kanë qenë rreth 120 000. Këto të dhëna shpesh janë deklaruar edhe nga zyrtarë të lartë të vendit.<sup>11</sup> Ekspertët vlerësojnë se këto dëme materiale vlerësohen të jenë mbi 22 miliardë euro.<sup>12</sup>

Duke pasur parasysh të dhënat e lartcekura, zbatimi i mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale në Kosovë është i një rëndësie të veçantë, në mënyrë që të trajtohen në mënyrë meritore të gjitha këto shkelje dhe të krijohen garancitë se asnjëherë në të ardhmen nuk do të këtë shkelje masive të të drejtave të njeriut.

### **Baza ligjore dhe kompetenca e Avokatit të Popullit**

Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta): “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”

Po ashtu Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit thotë se Avokati i Popullit, midis të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe*

<sup>8</sup> <https://www.osce.org/files/f/documents/d/d/17772.pdf>

<sup>9</sup> <https://www.hrw.org/reports/2001/kosovo/>

<sup>10</sup> E qasshme në: <https://reliefweb.int/report/albania/unicef-weekly-kosovo-update-01-oct-1999>

<sup>11</sup> Intervista e kryeministrit Albin Kurti në televizionin zviceran Blick TV - Zyra e Kryeministrit. E qasshme në: <https://kryeministri.rks-gov.net/blog/intervistae-e-kryeministrit-akbin-kurti-ne-televizionin-zviceran-blick-tv/>

<sup>12</sup> Radio Evropa e Lirë. “Mbi 22 miliardë euro dëme të luftës”. Publikuar më 23.9.2018. E qasshme në <https://www.evropaelire.org/a/mbi-22-miliarde-euro-deme-te-luftes-/29505183.html>

*faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. (neni 16, paragrafi 4);*

- *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, pika 1.2);*
- *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, pika 1.5);*
- *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; (neni 18, paragrafi 1, pika 6);*
- *të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.” (neni 18, paragrafi 1, pika 1.7).*

### **Përmbajtja dhe synimi i këtij raporti**

Raporti ofron një përshkrim të shkurtër të Drejtësisë Tranzicionale dhe përmend shkurtimisht instrumentet ndërkombëtare që parashikojnë dhe rregullojnë zbatimin e mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale. Raporti gjithashtu ofron një pasqyrë të shkurtër të zbatimit të mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale në vende të tjera. Pjesa qendrore e raportit ofron një pasqyrë të detajuar mbi zbatimin në praktikë të mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale në Kosovë, duke përfshirë: të drejtën për të ditur, të drejtën në drejtësi, të drejtën në reparacione dhe reformat institucionale. Në fund të raportit përmenden gjetjet kryesore dhe në bazë të këtyre gjetjeve nxirren rekomandimet.

Ky raport synon në rend të parë t'i identifikojë të gjitha nismat, qofshin institucionale apo të shoqërisë civile, në fushën e Drejtësisë Tranzicionale dhe ta analizojë zbatimin e këtyre nismave dhe në bazë të analizës ta bëjë vlerësimin nëse institucionet e shtetit kanë bërë mjaftueshëm dhe e kanë përmbushur obligimin e tyre në realizimin e të drejtave të njeriut për shkeljet masive të tyre në periudhën e luftës në Kosovë. Gjithashtu ky raport synon të ofrojë rekomandime për politika dhe nisma të reja dhe përmirësimin e funksionimit të nismave ekzistuese në fushën e Drejtësisë Tranzicionale, të cilat do të ndikojnë në realizimin më të madh të të drejtave të viktimave për drejtësi dhe për reparacione, si dhe në realizimin e së drejtës për të ditur dhe garantimin e mospërsëritjes.

### **Historik i shkurtër mbi Drejtësinë Tranzicionale**

Drejtësia Tranzicionale si koncept paraqitet vetëm pas Luftës së Dytë Botërore dhe në fillim më shumë ka nënkuptuar drejtësinë retributive (ndëshkuese) sesa atë restorative (rindërtuese). Themelimi i Tribunalit Ushtarak Ndërkombëtar të Nurembergut e pastaj edhe i Tribunalit të Tokios shënojnë zanafillat e para të Drejtësisë Tranzicionale, por që ishin të fokusuar më shumë në ndjekjen penale të përgjegjësve për krimet masive të kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pothuajse në të njëjtën kohë ka filluar edhe denazifikimi i Gjermanisë dhe i



Austrisë, e që ishte një nismë e aleatëve për t'i spastruar shoqëritë e këtyre dy vendeve nga ideologjia naziste. Ky proces u zhvillua përmes largimit nga pozitat e pushtetit dhe me ndikim të të gjithë atyre zyrtarëve, të cilët ishin anëtarë dhe përkrahës të partisë naziste dhe duke dobësuar dhe pamundësuar ekzistencën e organizatave pro naziste. Deri në pranverën e vitit 1946, rreth 42% e zyrtarëve publikë në Gjermaninë Perëndimore u shkarkuan. Ky proces është ekuivalent me atë që sot njihet si Proces i Vetingut, e që bën pjesë në reformat institucionale si shtyllë e Drejtësisë Tranzicionale.

Në konceptin e Drejtësisë Tranzicionale, reparacionet janë të një rëndësie të veçantë, sepse, përpos që janë formë e kompensimit direkt të viktimave, apo shihen edhe si element që ndihmon në kthimin e dinjitetit të viktimave. Edhe reparacionet apo kompensimet e kanë zanafillën pas Luftës së Dytë Botërore. Në mars të vitit 1951 u bë një kërkesë nga ministri i Punëve të Jashtme i Izraelit, Moshe Sharett, i cili kërkoi kompensim prej 1.5 miliardë dollarësh në emër të kostos financiare për rehabilitimin e 500 000 hebrenjve të mbijetuar. Kancelari i atëhershëm gjerman, Konrad Adenauer, e pranoi këtë kërkesë dhe u zotua se Gjermania Perëndimore ishte e gatshme të negocionte edhe për reparacione të tjera. Nga atëherë reparacionet, si ato materiale, edhe ato simbolike, duke përfshirë edhe kërkimfaljen, janë praktikuar në shumë vende pas përfundimit të konfliktit ose pas rënies së regjimit diktatorial.

Deri në vitet e 80-ta të shekullit XX nuk kishte ndonjë risi tjetër në fushën e Drejtësisë Tranzicionale. Në fund të viteve të 80-ta dhe në fillim të viteve të 90-ta ndodhi një zhvendosje e fokusit në Drejtësinë Tranzicionale, duke u zgjeruar nga çështjet e ngushta të drejtësisë penale në atë të zhvillimit demokratik të institucioneve dhe të rinovimit të shoqërisë, duke pasur parasysh obligimin ligjor dhe atë moral të artikuluar në konsensusin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Një risi krejt e veçantë është shfaqja e komisioneve të së vërtetës. Kjo së pari ka filluar në Amerikën Jugore, me Argentinën në vitin 1983 dhe në Kili në vitin 1990, duke u zhvilluar tutje me Komisionin e së Vërtetës dhe Pajtimin në Afrikën e Jugut, në vitin 1995. Që nga atëherë, komisionet e së vërtetës janë bërë simbol i Drejtësisë Tranzicionale duke u shfaqur në shoqëritë pas konflikteve në tërë botë.

Megjithëse Drejtësia Tranzicionale është përfshirë nga shumë sfida dhe kritika, edhe me faktin se është e vështirë matja e ndikimit të saj, duket se zbatimi i mekanizmave të saj nuk ka pasur asnjë ndikim negativ në praktikën e të drejtave të njeriut. Kjo e bën Drejtësinë Tranzicionale të zbatueshme, posaçërisht në periudhat e shtetndërtimit dhe të promovimit të demokracisë në vendet pas konfliktit. Prandaj Drejtësia Tranzicionale ka një zhvillim të hovshëm viteve të fundit.

### **Instrumentet ndërkombëtare që parashikojnë dhe rregullojnë zbatimin e mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale**

E drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ofron një kornizë për Drejtësinë Tranzicionale përmes një sërë instrumentesh dhe konventave, siç janë: Karta e Kombeve të Bashkuara, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dëmeve të tjera Mizore, Çnjerëzore dhe



Poshtëruese, Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës etj. Më poshtë do të shtjellohen të gjitha nenet e këtyre instrumenteve të cilat janë relevante për Drejtësisë Tranzicionale.

### **Karta e Kombeve të Bashkuara**

Karta e OKB-së kodifikon parimet kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare, nga barazia sovrane e shteteve e deri te ndalimi i përdorimit të forcës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, organ kryesor gjyqësor i Kombeve të Bashkuara, funksionon në përputhje me Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili është aneksuar në Kartën e OKB-së dhe është pjesë përbërëse e saj (shih Kapitullin XIV, neni 92).<sup>13</sup>

### **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut**

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut u miratua dhe u shpall nga Asambleja e Përgjithshme si një standard i përbashkët arritjesh për të gjithë popujt dhe për të gjitha kombet, me qëllim që çdo individ dhe çdo organ i shoqërisë, duke e mbajtur vazhdimisht parasysh këtë Deklaratë, të përpiqet përmes mësimit dhe edukimit ta nxisë respektimin e këtyre të drejtave dhe të lirive dhe me masa progresive, kombëtare dhe ndërkombëtare ta sigurojë njohjen dhe respektimin e tyre universal dhe efektiv, si midis popujve të vetë shteteve anëtare, ashtu edhe midis popujve të territoreve nën juridiksionin e tyre. Neni 8 përcakton: “*Secili ka të drejtën e një mjeti juridik efektiv nga gjykatat kombëtare kompetente për aktet që cenojnë të drejtat themelore që i janë dhënë me kushtetutë ose me ligj.*”<sup>14</sup>

### **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike**

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike<sup>15</sup> është një traktat ndërkombëtar i të drejtave të njeriut, i miratuar në vitin 1966. Ky Pakt ua mundëson njerëzve të gëzojnë një gamë të gjerë të të drejtave të njeriut. Më konkretisht, neni 2 i Paktit përcakton:

*“1. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet të respektojë dhe t’u sigurojë të gjithë njerëzve që ndodhen në territorin e tij dhe që varen nga juridiksioni i tij, të drejtat e njohura në këtë Pakt, pa kurrfarë dallimi të bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe, opinion politik ose çdo opinion tjetër, origjinë kombëtare apo shoqërore, pasuri, lindje ose çdo gjendje tjetër. 2. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet, në përputhje me procedurat e tij kushtetuese dhe me dispozitat e këtij Pakti, të marrë hapa të nevojshëm të cilët do të lejojnë marrjen e masave të tilla legjislative ose të masave të tjera të nevojshme që të mund t’i zbatojë të drejtat e njohura në këtë Pakt të cilat ende nuk janë parashikuar. 3. Çdo shtet palë i këtij Pakti zotohet: (a) Të sigurojë që çdo person, kur t’i shkelen të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Pakt, të ketë të drejtën e një mjeti juridik efektiv, edhe atëherë kur shkelen e kryejnë personat me rastin e ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare: (b) Të sigurojë që autoriteti kompetent gjyqësor, administrativ ose legjislativ, ose çdo autoritet tjetër që është kompetent në bazë të legjislacionit të shtetit, do t’i përcaktojë të drejtat e këtij personi që paraqet mjetin juridik si*

<sup>13</sup> Për më shumë shih: <https://www.un.org/en/about-us/un-charter>

<sup>14</sup> Neni 8 - Çdokush ka të drejtën e një mjeti juridik efektiv nga gjykatat kombëtare kompetente për aktet që cenojnë të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligji. E qasshme në: <https://www.ohchr.org/en/transitional-justice/international-standards>

<sup>15</sup> Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. E qasshme në: <https://hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>

dhe të zhvillojë mundësitë e paraqitjes së mjetit juridik. (c) Të sigurojë që autoritetet kompetente do të veprojnë sipas çdo mjeti juridik që do të njihet si i përligjur.”

### **Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë**

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë<sup>16</sup> është instrumenti i parë universal ligjërishit i detyrueshëm për të drejtat e njeriut në lidhje me zhdukjen me forcë. Ajo përshkruan detyrimet e shteteve palë ndaj këtij fenomeni si dhe të drejtat themelore të viktimave.<sup>17</sup>

*“(Neni 23) Çdo Shtet Palë do të sigurojë që trajnimi i personelit të zbatimit të ligjit dispozitat përkatëse të kësaj Konvente, personelit civil ose ushtarak, personelit mjekësor, zyrtarëve publikë dhe personave të tjerë që mund të përfshihen në ndalimin ose trajtimin e çdo personi të privuar nga liria;*

- *të sigurojë që urdhrat ose udhëzimet që përshkruajnë, autorizojnë ose inkurajojnë zhdukjen e detyruar janë të ndaluara dhe të garantoj që një person që refuzon t'i bindet një urdhri të tillë nuk do të ndëshkohet;*
- *të marrë masat e nevojshme për të siguruar që personat e përmendur më lartë, të cilët kanë arsye të besojnë se një zhdukje me forcë ka ndodhur ose është planifikuar, t'ua raportojnë çështjen eprorëve të tyre dhe, kur është e nevojshme, autoritetet ose organet përkatëse të ngarkuara me kompetencat e rishikimit ose korigjimit.*
- *(Neni 24) të hetojë aktet e zhdukjes me forcë dhe të sjellë përgjegjësit para drejtësisë; të sigurojë që zhdukja me forcë të përbëjë një vepër penale sipas ligjit të tij penal;*
- *vendos juridiksionin mbi veprën e zhdukjes me forcë kur autori i dyshuar është brenda territorit të tij, edhe nëse nuk është shtetas ose banor; të bashkëpunojë me shtetet e tjera për të siguruar që shkelësit të ndiqen penalisht ose të ekstradohen, dhe për të ndihmuar viktimat e zhdukjes me forcë ose gjetjen dhe kthimin e eshtrave të tyre; respektojnë standardet minimale ligjore rreth privimit të lirisë, duke përfshirë të drejtën e dënimit me burg për t'u kundërshtuar para gjykatave; të krijojë një regjistër të atyre që aktualisht janë të burgosur dhe të lejojë që ai të inspektohet nga të afërmit dhe avokatët; të sigurojë që viktimat e zhdukjes me forcë ose ato të prekura drejtpërdrejt nga ajo të kenë të drejtën për të marrë dëmshpërblim dhe kompensim.*
- *e drejta për të marrë dëmshpërblim mbulon materiale dhe rreziqe dhe, sipas rastit, forma të tjera të dëmshpërblimit si p.sh. a) Rikthimi. b) Rehabilitimi. c) Kënaqësia, duke përfshirë rivendosjen e dinjitetit dhe dëmshpërblimin. d) Garancia e mospërsëritjes.*

---

<sup>16</sup> Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë. E qasshme në <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-convention-protection-all-persons-enforced>

<sup>17</sup> <https://reliefweb.int/report/world/reporting-under-international-convention-protection-all-persons-enforced-disappearance>

## **Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dëmeve të tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Poshtëruese**

Kjo Konventë ka për synim ta bëjë më efektive luftën kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese në mbarë botën. Shumica e dispozitave të Konventës Kundër Torturës kanë të bëjnë me detyrimet e shteteve palë. Këto detyrime mund të përmblihen si më poshtë<sup>18</sup>:

*“(i) Çdo shtet palë do të marrë masa efektive legislative, administrative, gjyqësore ose masa të tjera për të parandaluar aktet e torturës. Ndalimi i torturës do të jetë absolut dhe do të zbatohet edhe në gjendje lufte dhe në rrethana të tjera të jashtëzakonshme (neni 2);*

*(ii) Asnjë Shtet Palë nuk mund të dëbojë ose ekstradojë një person në një shtet ku ka arsye thelbësore për të besuar se ai do të rrezikohet t'i nënshtrohet torturës (neni 3);*

*(iii) Çdo Shtet Palë do të sigurojë që aktet e torturës të jenë vepra penale të rënda brenda sistemit të tij ligjor (neni 4);*

*(iv) Neni 5<sup>19</sup> përcakton rastet kur një shtet palë mund të marrë masa për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat e përmendura në Nenin 4;*

*(v) Çdo shtet palë, në kushte të caktuara, do të marrë në paraburgim një person të dyshuar për veprën penale të torturës dhe do të bëjë një hetim paraprak mbi faktet (neni 7);*

*(vi) Çdo shtet palë ose do të ekstradojë një person të dyshuar për veprën penale të torturës ose do t'ia paraqesë çështjen autoriteteve të veta për ndjekje (neni 12);*

*(vii) Çdo Shtet Palë do të mbajë nën rishikim sistematik rregullat, udhëzimet, metodat dhe praktikat e marrjes në pyetje, si dhe masat për mbajtjen dhe trajtimin e personave që i nënshtrohen çdo forme arrestimi, ndalimi ose burgimi në çdo territor nën juridiksionin e tij, me synimin për të parandaluar ndonjë rastet e torturës (neni 13).*

*(viii) Çdo Shtet Palë do të sigurojë që autoritetet e tij të bëjnë hetime kur ka bazë të arsyeshme për të besuar se një akt torture është kryer (neni 14).”*

## **Pasqyrë e shkurtër e zbatimit të mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale në vende të tjera**

Shumë shtete të dala nga luftërat apo nga regjimet diktatoriale kanë tentuar ta adresonin të kaluarën e tyre përmes ngritjes së mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale. Janë krijuar modele të ndryshme, ndërsa shumica prej tyre më shumë janë bazuar në drejtësinë restorative (rindërtuese) sesa në drejtësinë retributive (ndëshkuese), për shkak të pamundësisë që t'i ndiqnin penalisht të gjithë përgjegjësit për krimet e kryera. Në shumicën e rasteve konteksti

<sup>18</sup> [https://legal.un.org/avl/pdf/ha/catcidtp/catcidtp\\_e.pdf](https://legal.un.org/avl/pdf/ha/catcidtp/catcidtp_e.pdf).

<sup>19</sup> “1. Çdo Shtet Palë do të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi veprat e përmendura në nenin 4 në rastet e mëposhtme: (a) Kur veprat penale kryhen në çdo territor nën juridiksionin e tij ose në bordin e një anijeje ose avioni të regjistruar në atë shtet; (b) Kur shkelësi i supozuar është shtetas i atij Shteti; (c) Kur viktimi është shtetas i atij shteti nëse ai shtet e konsideron të përshtatshme. 2. Çdo Shtet Palë do të marrë gjithashtu masa të nevojshme për të vendosur juridiksionin e tij mbi këto vepra në rastet kur shkelësi i supozuar është i pranishëm në çdo territor nën juridiksionin e tij dhe nuk e ekstradon atë në përputhje me nenin 8 tek ndonjë nga shtetet. përmendur në paragrafin I të këtij neni 3. Kjo Konventë nuk përjashton asnjë juridiksion penal të ushtruar në përputhje me ligjin e brendshëm.”

ka qenë i tillë kur një shoqëri është dashur të ballafaqohet me shkeljet masive të të drejtave të njeriut brenda kufijve të vendit, ku edhe pas përfundimit të konfliktit palët e armiqësuar kanë qenë në po atë vend. Kjo ka ndodhur në vendet e Amerikës Jugore, si: në Argjentinë, në Kili, në Brazil, në Kolumbi, në El Salvador, në Guatemalë, në Paraguai, në Peru dhe në Uruguai. Të gjitha këto vende kanë kaluar nëpër regjime diktatoriale dhe/apo kanë përjetuar luftëra civile, por brenda vendit të tyre. Edhe Afrika e Jugut është ballafaquar me të kaluarën e vet, ku një pakicë raciale, e cila ka qenë në pushtet, ka abuzuar me të drejtat elementare të shumicës dhe ka zbatuar politika të përjashtimit dhe të segregacionit të ashpër, që është cilësuar si aparteid. Edhe në rastin e Afrikës së Jugut, gjatë periudhës së tranzicionit, më shumë janë zbatuar mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale, që kanë përkuar me drejtësinë restorative (rindërtuese). Më i njohuri dhe që merret si model është Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtitimit (TRC) në Afrikën e Jugut, i cili shihet si një komision i cili ka pasur sukses. Kjo ngase ky komision ka pasur kompetenca shumë më të mëdha sesa ndonjë komision i ngjashëm deri në atë kohë. Ky është komisioni i vetëm i së vërtetës, i cili, përveç të tjerash, ka pasur mandat të ofronte amnisti, të pjesshme apo të plotë, për kryerësit e krimeve.<sup>20</sup>

Megjithatë, ka edhe raste të tilla ku krimet janë kryer nga njëra palë, e cila, pas përfundimit të luftës, e ka lëshuar territorin e atij shtetit, pra bëhet fjalë për forcat okupatore të një shteti tjetër. Rasti i tillë ka ndodhur në Timorin Lindor.

### **Shembulli i Timorit Lindor (Timor-Leste): Drejtësia e Mohuar**

Timori Lindor është një shtet ishull në Azinë Juglindore. Që nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë Timori Lindor është kolonizuar nga Portugalia, e cila është tërhequr vetëm në vitin 1975, duke lënë një zbrazëti në qeverisje, duke shkaktuar një luftë civile mes partive politike rivale. Kjo situatë është shfrytëzuar nga Indonezia fqinje, e cila e ka mbajtur të okupuar këtë vend për 24 vjet më radhë. Gjatë kësaj periudhe, Timori Lindor ka përjetuar krime të rënda, përfshirë: vrasje, zhdukje të dhunshme, dhunë seksuale, tortura, kidnapime të fëmijëve dhe abuzime të tjera. *“Llogaritjet janë të pasigurta, por diku midis 102.000 deri në 200.000 qytetarë të Timorit Lindor besohet se kanë humbur jetën si pasojë gjatë kësaj periudhe.”* Pas rënies së regjimit të Indonezisë në vitin 1999, 78.5 për qind e qytetarëve të Timorit Lindor votuan për pavarësinë në një referendum të organizuar nga OKB-ja, i cili u pasua nga dhuna sistematike nga forcat e sigurisë të Indonezisë dhe milicia e tyre e përbërë nga timorezë lokalë. Kjo mori jetën e më shumë se 1 400 njerëzve dhe shkatërrimin e pjesës më të madhe të infrastrukturës së Timorit Lindor. Ndërhyrja e trupave të autorizuara nga OKB-ja dhe krijimi i Administratës Tranzicionale të OKB-së në Timorin Lindor (UNTAET) ia hapi rrugën Timorit Lindor për t'u bërë një shtet i pavarur në maj të vitit 2002. Një Tribunal, mundësisht ndërkombëtar, është parë si një mjet që mund ta zbatojë të drejtën ndërkombëtare dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare. Për më tepër, drejtësia penale shihej si e nevojshme për ta riparuar çekuilibrin moral midis viktimës dhe autorit, pasi ndëshkon autorin dhe rikthen dinjitetin e viktimës. Pavarësisht thirrjeve për një gjykatë ndërkombëtare, si ato në ish-Jugosllavi apo në Ruandë, një proces i posaçëm gjyqësor për t'i hetuar krimet e rënda të kryera gjatë konfliktit u krijua nga OKB-ja. Megjithatë, përgjigjja zyrtare e Indonezisë ishte vazhdimisht negative, e cila rezultoi të ishte pengesa më e madhe politike për ta ndjekur

<sup>20</sup> E qasshme në: [https://www.gov.za/sites/default/files/gcis\\_document/201409/trc0.pdf](https://www.gov.za/sites/default/files/gcis_document/201409/trc0.pdf)

drejtësinë për shkeljet e të drejtave të njeriut në Timorin Lindor. Gjykata paditi rreth 400 të dyshuar në një gjykatë ad-hoc, me seli në Xhakartë (Indonezi). Megjithatë, gjykata ad-hoc ishte subjekt i një shqyrtimi dhe kritike të konsiderueshme.<sup>21</sup> Deri më tani, vetëm të akuzuarit timorezë u paraqitën para gjykatës dhe shumica e personave të akuzuar mbetën të lirë në Indonezi. Për më tepër, institucioneve shtetërore të Timorit Lindor u mungon vullneti politik dhe kapaciteti gjyqësor për të ndërmarrë hetime dhe ndjekje penale. Duke qenë se në masë të madhe sistemi indonezian nuk i besohet dhe kryesisht shihet si i korruptuar, Timori Lindor për këtë arsye miratoi praktikën e veta lokale për zgjidhjen e konflikteve. Të dy ish-kryeministrat, Gusmão dhe Ramos-Horta, miratuan një qasje pajtuese ndaj abuzimeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën në Timorin Lindor. Ata ofruan mbështetje të fortë për masat pajtuese, duke përfshirë dy komisionet e së vërtetës, CRTR dhe CTF. Më saktësisht, Komisioni për Pritje, të Vërtetën dhe Pajtimin (CAVR) u krijua në 2002 dhe hetoi shkeljet e kryera midis viteve 1974 dhe 1999 dhe gjithashtu sugjeroi masa për t'i parandaluar abuzimet në të ardhmen. Për më tepër, Indonezia dhe Timori Lindor krijuan Komisionin dypalësh për të Vërtetën dhe Miqësinë (CTF), në vitin 2005, me qëllim që të hidhte dritë në lidhje me të vërtetën e ngjarjeve të vitit 1999 dhe arritën në përfundimin se përgjegjësia për dhunën e vitit 1999 bie mbi forcat indoneziane. Vlen të përmendet se, si CAVR-ja ashtu edhe CTF-ja, rekomanduan dëmshpërblime për viktimat dhe një mekanizëm për hetimin dhe zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Megjithatë, këto rekomandime nuk u zbatuan dhe kishte një reagim të organizatave për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Amnesty International, që pohuan se është injoruar Thirrja për të vërtetën dhe reparacionet, e bërë nga Komisioni dypalësh i së Vërtetës.<sup>22</sup>

Në përgjithësi, është shumë e vështirë që mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale të zbatuar në një vend të merren si model i mirë për t'u zbatuar në një vend tjetër. Në fakt, kontekstet e ndryshme e bëjnë të domosdoshme hartimin e strategjive në bazë të nevojave të shteteve veç e veç.

### **Zbatimi në praktikë i mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale në Kosovë**

Ky kapitull synon t'i prezantojë mekanizmat dhe iniciativat që kanë të bëjnë me Drejtësinë Tranzicionale, që janë iniciuar në Kosovë nga institucionet vendore apo nga institucionet ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Ndër të tjera do të përmbajë analiza të të njëjtave, duke përfshirë vlerësimin e suksesit dhe të dështimeve të tyre.

Mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale vazhdimisht janë kritikuar se janë kuptuar dhe zbatuar si një model ose si pjesë e një grupi të ngushtë masash, të cilat do të gjenin zbatim në mënyrë uniforme kudo ku ka pasur shkelje të përhapura të të drejtave të njeriut, por pa i konsideruar shumë nevojat dhe perspektivat e ndryshme të të prekurve dhe të komunitetit.<sup>23</sup> Që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, shumë palë i kanë adresuar shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera në Kosovë gjatë dhe pas luftës. Nivelet dhe mënyrat se si u adresuan këto shkelje ndryshojnë në një masë të madhe mes institucioneve relevante.

---

<sup>21</sup> Përshkrim i shkurtër i Gjykatës Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale për Timor- Leste. E qasshme në: <https://www.ictj.org/location/timor-leste>

<sup>22</sup> <https://www.refworld.org/docid/51e92f404.html>

<sup>23</sup> <https://paxforpeace.nl/media/download/Citizens%20Perspective%20on%20a%20Future%20Strategy%20for%20Transitional%20Justice%20in%20Kosovo%20PAX%202020.pdf>



Në dy dekadat e fundit përpjekjet për ballafaqim me të kaluarën dhe Drejtësia Tranzicionale janë zhvilluar pa një strategji gjithëpërfshirëse. Ballafaqimi kryesisht është bërë në sektorë specifikë përmes iniciativave dhe rrugëve institucionale dhe ligjore për t'u trajtuar veçmas çështje të ndryshme që lidhen me konfliktin. Megjithatë, përkundër nevojës urgjente për t'u marrë me të kaluarën, e njëjta është anashkaluar si rezultat i dy faktorëve kryesorë. Së pari, rol të madh kanë luajtur statusi i pazgjidhur politik i Kosovës dhe prioritizimi i stabilizimit afatshkurtër dhe i agjendës së shtetndërtimit. Së dyti, mungesa e marrëveshjes përfundimtare ndërmjet Serbisë dhe Kosovës ka vendosur një trajktore negative, e cila ka ndikuar dukshëm në politikën e Drejtësisë Tranzicionale në Kosovë dhe më gjerë.<sup>24</sup>

Shumica e përpjekjeve për t'u marrë me të kaluarën e kohës së luftës në Kosovë janë fokusuar në ndjekjen e krimeve të luftës pa investuar shumë në mekanizma të tjerë të Drejtësisë Tranzicionale për ta mbështetur shoqërinë ta ndërtonte një të ardhme më paqësore. Deri më tani, shumica e vëmendjes u është kushtuar gjykimeve të krimeve të luftës nga ana e gjykatave nën administrimin ndërkombëtar, gjykatave hibride dhe vendore në Kosovë. Drejtësia për krimet e luftës dhe të shkeljeve të tjera serioze të të drejtave të njeriut kërkohet përmes mekanizmave të veçantë gjyqësorë dhe nën autoritete të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare. Ndërsa gjetja e së vërtetës, më konkretisht, fati i personave të zhdukur dhe nismat e kërkimit të së vërtetës u janë lënë në duar agjencive të specializuara dhe grupeve të shoqërisë civile. Përqendrimi mbizotërues në gjykimet e krimeve të luftës ka ndikuar në aspekte të tjera të rëndësishme të ballafaqimit me të kaluarën, si: kërkimi dhe dokumentimi i së vërtetës, përkujtimi, dëmshpërblimet dhe kompensimi, si dhe njohja dhe mbështetja për të gjitha viktimat dhe për të mbijetuarit e konfliktit, pavarësisht nga identiteti dhe statusi i tyre.<sup>25</sup>

Shpeshherë ka pasur dallime mes palëve vendore dhe ndërkombëtare, të cilat konsiderohet së janë shkaktuar nga shtresat e pazakonshme të pushtetit, të përgjegjësisë si dhe të ekspertizës. Kjo ka rezultuar në krijimin e opinionit publik për paaftësinë për të arritur rezultate konkrete duke krijuar në këtë mënyrë pakënaqësi të përgjithshme.

Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës ofron disa udhëzime për t'u përballur me krimet e luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut. Propozimi veçanërisht e obligon Kosovën që "ta respektojë në tërësi procesin e pajtimit mes të të gjitha komuniteteve të saj dhe pjesëtarëve të tyre".<sup>26</sup> Si i tillë, ky dokument ia lë në duar institucioneve të Kosovës të zhvillojnë strategji se si do të merren me pajtimin dhe me aspektet e tjera të padrejtësive të së kaluarës. Sipas dokumentit, Kosova "do të zbatojë një qasje gjithëpërfshirëse, me ndjeshmëri gjinore, për t'u ballafaquar me të kaluarën e saj, e cila do të përfshijë një varg të gjerë nismash tranzicionale të drejtësisë".<sup>27</sup> Përveç këtij udhëzimi që Propozimi ua jep

---

<sup>24</sup> KIPRED (2009). "Drejtësia tranzicionale në Kosovë". E qasshme në:  
[http://www.kipred.org/repository/docs/Drejt%C3%ABsia\\_tranzicionale\\_n%C3%AB\\_Kosov%C3%AB\\_\\_9088;51.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Drejt%C3%ABsia_tranzicionale_n%C3%AB_Kosov%C3%AB__9088;51.pdf)

<sup>25</sup> E qasshme në:  
<https://paxforpeace.nl/media/download/Citizens%20Perspective%20on%20a%20Future%20Strategy%20for%20Transitional%20Justice%20in%20Kosovo%20PAX%202020.pdf>

<sup>26</sup> KIPRED (2007). "Analizë e Propozimit Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës". Analizë Politikash Nr. 5. E qasshme në:  
[https://www.kipred.org/repository/docs/Analiz%C3%AB\\_e\\_Propozimit\\_Gjith%C3%ABp%C3%ABrshir%C3%ABs\\_p%C3%ABr\\_Marr%C3%ABveshjen\\_p%C3%ABr\\_Statusin\\_e\\_Kosov%C3%ABs\\_836154.pdf](https://www.kipred.org/repository/docs/Analiz%C3%AB_e_Propozimit_Gjith%C3%ABp%C3%ABrshir%C3%ABs_p%C3%ABr_Marr%C3%ABveshjen_p%C3%ABr_Statusin_e_Kosov%C3%ABs_836154.pdf)

<sup>27</sup> Po aty.



institucioneve të Kosovës, tërthorazi përkujdeset për segmente të caktuara të drejtësisë tranzicionale, kryesisht përmes integritetit, legjitimitetit dhe përgjegjësisë së institucioneve.

Një tjetër dokument kyç është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, që hyri në fuqi më 15 qershor 2008. Sipas dispozitave të saj për “Përgjegjësitë e shtetit”, Kushtetuta bën thirrje të “promovojë frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve”. Ky është i vetmi rast ku Kushtetuta i drejtohet çështjes së pajtimit dhe të tolerancës ndëretnike.

Përpjekja e parë e Kosovës për të ofruar një strategji u lehtësua nga Grupi Punues Ndërmintor për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtimin, në vitin 2008. Kjo nismë dështoi për shkak të pengesave dhe të mangësive në udhëheqje dhe në menaxhim, të metave specifike të projektimit dhe mungesës së madhe të vullnetit politik dhe moskoordinimit.<sup>28</sup>

Në gusht 2021 u inaugurua nisma për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Drejtësi Tranzicionale (SKDT), e cila kishte qëllim t’i bashkonte të gjitha iniciativat dhe të ofronte një platformë për veprim dhe koordinim ndërmjet nismave si dhe një platformë referimi për të gjithë ata që kanë të bëjnë me të kaluarën.<sup>29</sup>

Në gusht të vitit 2021 u krijua Grupi Punues për hartimin e Strategjisë për Drejtësi Tranzicionale.<sup>30</sup> Grupi Punues përbëhet prej 26 anëtarësh, të cilët do të bëjnë kërkime dhe konsultime me palët e interesuara ashtu që të hartohet përfundimisht një dokument, për t’u dërguar më pas për procedura dhe votim në parlament. “*Ky angazhim i ripërtërirë shënon një nivel të ri të pjekurisë politike dhe mundësive për shoqërinë kosovare, duke i funksionalizuar efektivisht objektivat afatgjata politike të Kosovës për t’i dhënë fund pandëshkueshmërisë, promovimin e drejtësisë dhe pajtimit - si parakusht për të promovuar stabilitetin politik dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.*”<sup>31</sup>

Në vazhdim do të shqyrtohen katër mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale dhe veprimet e ndërmarra drejt zbatimi të tyre në Kosovë përgjatë dy dekadave të fundit.

## **E drejta për drejtësi**

Një nga instrumentet kryesore të Drejtësisë Tranzicionale është “E drejta për drejtësi”, e cila ka të bëjë me ndjekjet dhe gjykimet penale të përgjegjësve për shkeljet e rënda të ligjit ndërkombëtar, e që janë: krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, tortura, zhdukjet e dhunshme dhe gjenocidi.

---

<sup>28</sup> Ahmetaj N., dhe Unger, Th. (2017). “Korniza e Kosovës për Trajtimin e të Kaluarës në Një Pikë Kthese: Vlerësim nga shoqëria civile për progresin drejt hartimit të Strategjisë Kombëtare për Drejtësinë Tranzicionale”, e qasshme në: <https://ngo-integra.org/publication/Vler%C3%ABsim%20nga%20shoq%C3%ABria%20civile%20p%C3%ABr%20hartimin%20e%20Strategjis%C3%AB%20Komb%C3%ABtare%20p%C3%ABr%20Drejt%C3%ABsin%C3%AB%20Tranzicionale.pdf>

<sup>29</sup> Fondi për të Drejtën Humanitare (2022). “Drejt një Strategjie Kombëtare të Drejtësisë Tranzicionale”. E qasshme në: <https://hlc-kosovo.org/storage/app/media/Strategjia%202022/DREJT%20NJ%C3%8B%20STRATEGJIE%20KOMB%C3%8BTARE%20T%C3%8B%20DREJT%C3%8BSIS%C3%8B%20TRANZICIONALE%20P%C3%8BR%20KOSOV%C3%8BN.pdf>

<sup>30</sup> Ministria e Drejtësisë. “U mbajt takimi i parë i Grupit Punues për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Drejtësi Tranzicionale”. E qasshme në: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,2540>

<sup>31</sup> Po aty.

E drejta për drejtësi përfshin të drejtën e viktimave për të marrë drejtësi përmes një mjete juridik të drejtë dhe efektiv. E drejta për drejtësi gjithashtu i detyron shtetet t'i hetojnë shkeljet dhe t'i ndjekë penalisht personat përgjegjës për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe t'i ndërmarrë veprimet ndëshkuese nëse vërtetohet fajësia. Rrjedhimisht kjo nënkupton se e njëjta duhet të pasohet me dëmshpërblim. Përgjegjësia kryesore për ta ushtruar juridiksionin bie mbi gjykatat kombëtare/vendore. Megjithatë, edhe gjykatat penale ndërkombëtare ose hibride mund ta ushtrorjnë njëkohësisht juridiksionin, siç janë: Tribunalet Ndërkombëtare, Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Gjykimet dhe ndjekjet penale, nga shumica, shihen si mekanizma kryesorë dhe më të rëndësishëm të Drejtësisë Tranzicionale. Gjykatat penale ndërkombëtare dhe të përziera janë themeluar në dekadat e fundit për t'i marrë në përgjegjësi shkaktarët e luftërave dhe të mizorive që u përhapën në vende e në rajone të caktuara, si: Ruandë, ish-Jugosllavi, Sierra Leone dhe Timori Lindor. Në veçanti, themelimi i Gjykatës Penale Ndërkombëtare tregon vendosmërinë dhe gatishmërinë ndërkombëtare për t'i gjykuar shkaktarët e disa prej formave më serioze të gjenocidit, të krimeve kundër njerëzimit si dhe të krimeve të luftës. Po ashtu, shumë ndjekje penale janë bërë në vendet e treta, përmes mbështetjes në parimet juridike, si: juridiksioni universal apo alternativisht në bazë të zotimeve të shteteve që kanë për traktate të caktuara.

Sidoqoftë, krimet e kryera gjatë dhe menjëherë pas luftës në Kosovë, e që janë kualifikuar si krime kundër njerëzimit apo krime lufte, deri më tani janë proceduar para disa gjykatave.

### **Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi (Tribunali i Hagës).**

Ky Tribunal është krijuar në vitin 1993 nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, si përgjigje për mizoritë që ishin duke ndodhur në luftërat në Kroaci dhe në Bosnje e Hercegovinë. Mandati kohor i këtij Tribunali shtrihej deri më 10 qershor 1999 kur përfundon lufta në Kosovë. Para këtij Tribunali janë proceduar 161 persona, 91 nga të cilët janë dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm. Për sa u përket krimeve të kryera në Kosovë, para kësaj gjykate janë proceduar 5 raste, në tri nga to janë akuzuar 9 serbë, zyrtarë të lartë politikë, policorë dhe ushtarakë, duke përfshirë edhe kryetarin e Jugosllavisë të viti 1999, Slobodan Millosheviq, dhe atë të Serbisë, Millan Millutinoviq. Gjatë gjykimit, 2 nga të akuzuarit kanë ndërruar jetë, njëri ndër ta është Slobodan Millosheviqi, ndërsa Millan Millutinoviq është shpallur i pafajshëm nga trupi gjykues. Të gjithë të tjerët, 6 të akuzuar, janë dënuar me aktgjykime të plotfuqishme për krime kundër njerëzimit të kryera në Kosovë. Nga ana tjetër ka pasur edhe dy aktakuza ndaj 6 ish-pjesëtarëve të UÇK-së. Në fund të këtyre proceseve dy prej tyre janë dënuar me aktgjykime të plotfuqishme. Në përgjithësi, Tribunali i Hagës ka dënuar 8 persona për krime kundër njerëzimit.

### **Gjykatat në Kosovë**

Aktakuzat e para për krimet e luftës në Kosovë së pari janë ngritur nga ana e prokurorëve vendorë, në fund të vitit 1999, e proceset gjyqësore janë zhvilluar nga gjyqtarët vendorë, të cilët janë propozuar nga ana e Këshillit të Përbashkët Këshillëdhënës, i cili ishte emëruar nga Përfaqësuesi Special i Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Megjithatë, që nga fillimi i vitit 2000, kompetencat ekskluzive në proceset gjyqësore për krime lufte i ka marrë UNMIK-u. Procedimi i lëndëve për krime lufte, para gjyqësorit në Kosovë, mund të ndahet në tri etapa:

në atë kur gjykimet janë administruar nga misioni i UNMIK-ut; pastaj nga misioni i BE-së – EULEX; dhe në periudhën kur kompetencat për gjykime për krime lufte janë bartur te prokurorët dhe gjyqtarët vendorë.

### **Misioni i UNMIK-ut**

Nga fillimi i vitit 2000, në panelet gjyqësore, që kanë vendosur lidhur me akuzat për krimet e luftës, ka filluar angazhimi i gjyqtarëve ndërkombëtarë. Deri në fund të misionit të UNMIK-ut, përkatësisht deri në fund të vitit 2008, gjykimet për krimet e luftës kryesisht janë zhvilluar para paneleve me gjyqtarë jovendorë.

Gjykimet e organizuara nga ana e Misionit të Kombeve të Bashkuara kanë zgjatur shumë dhe shumë shpesh rastet janë kthyer në rigjykim, më së shpeshti për shkak të hetimeve të zhvilluara në mënyrë joprofesionale.

Misioni i UNMIK-ut kompetencat për proceset gjyqësore për krime lufte tërësisht i ka bartur te misioni i BE-së, në prill të vitit 2009.

### **Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit - EULEX**

Gjykimet për krime lufte, për të cilat kanë qenë kompetentë gjyqtarët e EULEX-it, janë zhvilluar para paneleve gjyqësore me përbërje të përzier, por sikurse edhe gjatë misionit të UNMIK-ut, kryetarët e paneleve gjykuese dhe shumica e anëtarëve të paneleve kanë qenë gjyqtarë ndërkombëtarë. Vetëm në gjykatën në Mitrovicë (ish-Gjykata e Qarkut, tash ajo Themelore), gjykimet janë zhvilluar para paneleve gjyqësore të përbëra ekskluzivisht nga gjyqtarët ndërkombëtarë. Deri te reduktimi i mandatit të EULEX-it, krimet e luftës në Kosovë gjithashtu i kanë hetuar prokurorët ndërkombëtarë. Ata i kanë përgatitur aktakuzat dhe të njëjtat i kanë përfaqësuar para gjykatave.

Kohëzgjatja e Misionit fillimisht ishte paraparë deri në datën 14 qershor të vitit 2014. Mandati pastaj ishte vazhduar deri në datën 14 qershor të vitit 2016, në mënyrë që prapë të vazhdohej deri në datën 14 qershor të vitit 2018, kur përfundimisht i kishte dorëzuar kompetencat, për sa u përket proceseve gjyqësore për krime lufte, tek prokurorët dhe gjyqtarët vendorë. Misioni i EULEX-it, në fillim të mandatit të tij, në gjykimet për krimet e luftës ka treguar një sukses evident – duke rritur efikasitetin në proceset gjyqësore për krime lufte, transparencën dhe ekspeditivitetin. Gjithashtu proceset gjyqësore nga ana e EULEX-it janë organizuar në mënyrë të tillë e që nuk kanë zgjatur aq shumë sa gjatë periudhës së UNMIK-ut dhe ka pasur më pak raste të kthyer në rigjykim.

### **Gjyqtarët dhe prokurorët vendorë**

Kompetencat për hetimet e Krimeve të Luftës kishin filluar të barteshin tek prokurorët vendorë qysh në vitin 2014. Nga muaji qershor i vitit 2014, prokurorët e EULEX-it kanë qenë kompetentë për lëndët në të cilat hetimet kishin filluar para asaj date, kurse gjyqtarët vetëm në procedurat të cilat kishin qenë në vazhdim e sipër dhe në të cilat këta gjyqtarë kishin qenë kompetentë, e deri në përfundimin e procedurës penale, në të gjitha fazat. Nga ajo periudhë e tutje, të gjitha hetimet për raste të tjera janë bërë nga prokurorët vendorë, ndërsa gjyqtarët vendorë është dashur të ishin në shumicë në panelet gjyqësore, të cilat vendosnin për akuzat për krimet e luftës si dhe të kryesonin me panelet. Nga ana tjetër, në kuadër të Prokurorisë

Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), në maj të vitit 2015 u krijua Departamenti për Krime Luftë, i cili ndikoi në rritjen e kapaciteteve të prokurorisë për hetimin e krimeve të luftës. Më vonë, në vitin 2019, u themelua edhe Departamenti Special për Krime të Rënda,<sup>32</sup> pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës, i cili është kompetent t'i gjykojë rastet që vijnë nga PSRK-ja, duke përfshirë edhe krimet e luftës. Ndërkohë, në shkurt të vitit 2019, Këshilli Prokurorial i Kosovës, së bashku me Departamentin për Krime Luftë, pranë PSRK-së, hartuan edhe një strategji, të cilën ata e quajtën “Strategjia e Krimeve të Luftës”. Në këtë strategji, ndër të tjera, është paraparë që lëndët për krime luftë të prioritetizohen në bazë të kriterëve të përcaktuara dhe të bëhet rritja e kapaciteteve të prokurorisë dhe të policisë. Sipas strategjisë, rritja e kapaciteteve parasheh një numër të madh të masave që duhen ndërmarrë, e ndër të tjera parashihet edhe vendosja e bashkëpunimit me Mekanizmin Rezidual për Tribunalet Ndërkombëtare (pasuesi i Tribunalit të Hagës) dhe me vendet e rajonit.

Edhe përkundër krijimit të të gjithë këtyre mekanizmave dhe të strategjisë, as në numër të proceseve gjyqësore, por as në profilin e të akuzuarve për krime luftë, nuk ka pasur një efekt pozitiv deri në publikimin e këtij dokumenti. Pothuajse në të gjitha proceset gjyqësore që janë zhvilluar në vitet e fundit, të akuzuarit kanë qenë përgjegjës të profilit të ulët dhe nuk kanë pasur grada në policinë apo në ushtrinë serbe në kohën e kryerjes së krimeve. Sa për ilustrim, gjatë vitit 2021 është ngritur vetëm një aktakuzë për krime luftë, ndërsa janë mbajtur seancat gjyqësore në 11 lëndë për krime luftë me gjithsej 11 të akuzuar.<sup>33</sup>

Performanca e dobët edhe nga misionet ndërkombëtare, por edhe nga gjyqësori vendor, në ndjekjen penale të përgjegjësve për krime luftë dhe dështimi i tyre në sjelljen e drejtësisë për viktimat e krimeve të luftës dhe për familjet e tyre, më së miri pasqyrohen në të dhënat statistikore të bëra publike nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë (FDHK). Në një publikim<sup>34</sup> të kësaj organizate të vitit 2022, në Kosovë, nga viti 1999 e deri në vitin 2022, janë akuzuar për krime luftë gjithsej 117 persona dhe vetëm 45 prej tyre (35 shqiptarë, 9 serbë dhe 1 rom) janë dënuar me aktgjykime të plotfuqishme.

Një tjetër sfidë në proceset gjyqësore për krime luftë është mungesa e trajnimeve të rregullta për prokurorët dhe për bashkëpunëtorët profesionalë, që janë të angazhuar në Departamentin për Krime të Luftës, pranë PSRK-së. Meqenëse ky departament është relativisht i ri dhe prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesionistë nuk kanë përvojë të gjatë në lëndët për krime luftë, do të duhej të kishte programe më të avancuara të trajnimeve. Gjithashtu, edhe njësi i për krime luftë i Policisë së Kosovës nuk ka kaluar nëpër shumë trajnime mbi hetimin e krimeve të luftës, prandaj do ishte e rëndësishme ngritja e kapaciteteve profesionale.

Përveç sfidave të tjera, të cilat kanë ndikuar në një numër kaq të vogël të të dënuarve për krime luftë, një barrierë tepër e madhe përmendet si arsye kryesore dhe kjo është përmendur edhe në Strategjinë e Krimeve të Luftës. Bëhet fjalë për mosbashkëpunimin mes prokurorive të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë në ndjekjen penale të të pandehurve për krime

---

<sup>32</sup> Përshkrim për Departamentin për Krime të Rënda. E qasshme në: <https://prishtine.gjyqesori-rks.org/mire-sevini-ne-gjykatën-themelore-ne-prishtine/organogrami-i-gjyqesores/departamenti-per-krime-te-renda/>

<sup>33</sup> Fondi për të Drejtën Humanitare (2021). “Drejtësia për Viktimat e Luftës – Ku ka ngecur?” E qasshme në: <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Kosovo%20report%202021%20ALB%20SRB%20ENG.pdf>

<sup>34</sup> Fondi për të Drejtën Humanitare (2022). “Buletini për Drejtësi Tranzicionale”. <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Buletini%20per%20Drejtësi%20Tranzicionale%202022/Buletini%20per%20Drejtësi%20Tranzicionale.pdf>

lufte. Meqenëse shumica e kryerësve të krimeve të luftës në Kosovë supozohet të jenë në Serbi dhe për shkak të mungesës së bashkëpunimit organet e ndjekjes dhe të hetuesisë në Kosovë e kanë të pamundur të vijnë të te pandehurit. Prandaj Strategjia parasheh që “Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe PSRK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të zhvillojnë dhe miratojnë një protokoll të bashkëpunimit ndërmjet PSRK-së dhe Zyrës së Prokurorëve të Krimeve të Luftës të Serbisë.”<sup>35</sup> Për shkak të situatës politike mes Kosovës dhe Serbisë, ky bashkëpunim nuk ka mundur të realizohet. Edhe një veprim tjetër ligjor është ndërmarrë nga institucionet e Kosovës që të tejkalohet kjo barrierë. Vite më parë, dy deputete të Kuvendit të Kosovës kanë propozuar amendamentimin e Kodit të Procedurës Penale në mënyrë që të mundësohen gjykimet në mungesë për krimet e luftës. Në maj të vitit 2019 ishte votuar Ligji nr. 04/L – 123<sup>36</sup> për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Procedurës Penale, i cili e futi nën 346/A në Kodin e Procedurës Penale me të cilin mundësohen gjykimet në mungesë për veprat penale kundër së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe kundër së drejtës ndërkombëtare penale, në periudhën janar 1990 deri në qershor 1999. Ndryshimet e parapara me Ligjin nr. 04/L-123 janë reflektuar edhe në nenin 303 të Kodit të Ri të Procedurës Penale,<sup>37</sup> i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2022.

Gjatë periudhës kohore nga viti 1999 e deri më tani gjykimet për krime lufte janë zhvilluar nëpër gjykatat e qarkut, respektivisht nëpër gjykatat themelore në qarqet/distriktet e ndryshme në Kosovë dhe dokumentacioni nga këto gjykime ka mbetur në arkivat e këtyre gjykatave. Është shumë e vështirë të gjendet ky dokumentacion, sepse është i shpërndarë në shumë arkiva. Do të ishte e rëndësishme që dokumentacioni gjyqësor për krime lufte të ishte i centralizuar në një arkiv, në mënyrë që të mundë të gjendeshin dhe të shfrytëzoheshin më lehtë nga prokurorët, por edhe nga institucionet e tjera, nga hulumtuesit, nga studiuesit etj.

### **Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës**

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës u themeluan në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare e miratuar nga Kuvendi i Kosovës, Amendamenti kushtetues nr. 24<sup>38</sup>, si dhe në bazë të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës. “Ato janë institucione të përkohshme me mandat dhe juridiksion të përcaktuar për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera sipas legjislacionit të Kosovës, të cilat filluan të kryhen ose u kryen në Kosovë midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000 nga persona me shtetësi të Kosovës ose të Republikës Federale të Jugosllavisë, ose kundër personave me shtetësi të Kosovës ose të Republikës Federale të Jugosllavisë. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës kanë seli në Hagë, Holandë. Personeli i tyre është ndërkombëtar, sikurse janë edhe gjykatësit,

---

<sup>35</sup> Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit (2019), Strategjia e Krimeve të Luftës, e qasshme në: [https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Dokumente%20Strategjike/2019\\_03\\_29\\_125750\\_STRATEGJIA\\_E\\_KRIMEVE\\_TE\\_LUFTE.pdf](https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Dokumente%20Strategjike/2019_03_29_125750_STRATEGJIA_E_KRIMEVE_TE_LUFTE.pdf)

<sup>36</sup> Ligji nr. 06/L-091 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit të Procedurës Penale nr. 04/L-123. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20500>

<sup>37</sup> Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61759>

<sup>38</sup> Kuvendi i Kosovës, Amendamenti kushtetues nr. 24 (2015), i qasshëm në: <http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/Amendamenti%20kushtetues%20-nr%2024.pdf>



*Prokurori i Specializuar dhe Administratorja.*”<sup>39</sup> Përveç krimeve të lartcekura, këto Dhoma kanë juridiksion edhe mbi krime të tjera të parapara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (2012), në rastet kur ato ndërlihen me veprat penale kundër administrimit të drejtësisë dhe me ato të procedurave zyrtare.

Krijimit të këtyre Dhomave i ka paraprirë publikimi i librit “The Hunt: Me and the War Criminals” të Karla Del Ponte, ish-Kryeprokurore në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, në të cilin libër shkruan për pretendimet se gjatë luftës në Kosovë kishte trafikim të organeve njerëzore nga persona të cilët ishin ndaluar nga pjesëtarët e UÇK-së. Duke e marrë si bazë këtë libër, përfaqësuesi i Ruisë në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) propozoi një rezolutë. Pas këtij propozimi, Komisioni për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut i APKE-së vendosi ta dërgonte përfaqësuesin e saj në Kosovë, përkatësisht raportuesin special, Dick Marty, të bënte hetimin e pretendimeve për trafikim organesh dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut në Kosovë gjatë dhe pas luftës. Hulumtimi i tij përfundoi në vitin 2010 dhe u pasua nga raporti i titulluar: “Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve në Kosovë”, ku pretendohet se kishte prova për trafikim të organeve dhe për krime të tjera të rënda. Ky raport u adoptua nga APKE-ja në janar të vitit 2011 dhe u votua rezoluta 1782. Meqenëse hetimi i Dick Martyt nuk ishte hetim penal, atëherë KE-ja propozoi të krijohet një Task-Forcë Speciale Hetimore (SIFT), e cila u krijua nga EULEX-i dhe u udhëhoq nga prokurori, Clint Williamson. Nga tetori 2011 deri në gusht 2014, SIFT-i i zhvilloi hetimet dhe, sipas Williamsonit, kishte mbledhur prova bindëse kundër ish-zyrtarëve të lartë të caktuar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), prova të cilat pretendonin shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare, duke përfshirë krime kundër njerëzimit dhe krime të luftës. Ai deklaroi: “*SIFT mund të paraqesë aktakuzë kundër këtyre individëve vetëm atëherë kur të vendoset një mekanizëm gjyqësor i përshtatshëm.*” Pas kësaj deklarate të Williamsonit filluan veprimet për themelimin e Dhomave të Specializuara, që përfshijnë edhe ndryshimet kushtetuese dhe votimin në Kuvendin e Kosovës të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.<sup>40</sup> Edhe pse ky ligj ishte votuar në vitin 2015, aktakuzat e para janë ngritur në vitin 2020.

Që nga themelimi, Dhomat e Specializuara të Kosovës kanë qenë në shënjestër të kritikave në Kosovë. Njëra nga kritikimet më të mëdha ndaj kësaj gjykate është se ajo ndjek dhe gjykon vetëm krimet e njërës palë. Edhe pse zyrtarët e kësaj gjykate asnjëherë nuk e kanë pohuar këtë, megjithatë, neni 6 i Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës, i cili përcakton juridiksionin lëndor, në paragrafin e parë këtë juridiksion e formulon si në vijim: “*Dhomat e specializuara kanë juridiksion mbi krimet e parapara në nenet 12 – 16 që kanë të bëjnë me Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës.*” Në paragrafin e dytë përcakton juridiksionin mbi krimet që kanë të bëjnë me pengimin e administrimit të drejtësisë. Pra, nga ky nen mund të kuptohet se me të vërtetë kjo gjykatë do merret vetëm me krimet e caktuara, të cilat kanë qenë subjekt i hetimeve të senatorit, Dick Marty, dhe se shumica e krimeve të luftës nuk do të trajtohet në lëndët/proceset para kësaj gjykate.

---

Dhomat e Specializuara të Kosovës. E qasshmen në: <https://www.scp-ks.org/sq>

<sup>40</sup> Ligji nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=11036>



Avokati i Popullit, më 9 nëntor 2021, vizitoi Dhomat e Specializuara, ku u takua me kryetaren e Dhomave të Specializuara dhe me bashkëpunëtorët e saj. Gjithashtu realizoi edhe vizitë në qendrën e paraburgimit dhe takoi të paraburgosurit në Qendrën e Paraburgimit në Hagë. Avokati i Popullit takoi të paraburgosurit dhe me secilin prej tyre iu mundësua bisedë në hapësirë të veçantë dhe në kohë të mjaftueshme. Nga të paraburgosurit u ngritën një mori shqetësimesh, si: mosrespektimi i parimit të barazisë së armëve gjatë procesit gjyqësor, kohëzgjatja e paraburgimit, mungesa e mbikëqyrjes për të drejtën në mjet efikas juridik, duke aluduar në faktin se gjykata funksionon si një strukturë dhe nuk ka shkallëzim të shprehur për shqyrtimin efikas të mjeteve juridike, vonesa e përkthimeve të procesverbaleve të seancave gjyqësore në gjuhën shqipe, redaktimi i aktakuzës dhe i materialeve të tjera që ua mohon të drejtën që t'i kenë me kohë të gjitha provat dhe informatat në gjuhën që e kuptojnë, standardet e dyfishta të zbatimit të legjislacionit duke vendosur praktika që nuk janë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovë, trajtimin jo të barabartë me të burgosurit e tjerë për sa u përket masave kufizuese për mbrojtjen nga pandemia për vizita familjare, pasiviteti i Avokatit të Dhomave të Specializuara dhe mungesa e mënyrës konfidenciale për t'iu drejtuar etj.

## **E drejta për të ditur**

E drejta për të ditur përfshin të drejtat e viktimave dhe të familjeve të tyre për ta mësuar të vërtetën mbi atë çfarë u ka ndodhur atyre personalisht apo familjarëve dhe njerëzve të tyre të dashur. Kjo e drejtë bazohet në të drejtën e patjetërsueshme të shoqërisë për të ditur se cilat rrethana rezultuan në kryerjen e krimeve dhe të shkeljeve ashtu që të parandalohet përsëritja e tyre në të ardhmen. Përtej kësaj, kjo e drejtë ofron një detyrim të shtetit për të ndërmarrë masa, si: sigurimi i arkivave dhe i dëshmimeve të tjera, duke ruajtur dhe mirëmbajtur kujtesën kolektive nga zhdukja dhe duke luftuar revizionizmin dhe mohimit historik.

Sipas Parimeve të Kombeve të Bashkuara për Mosndëshkueshmëri: *“Çdo person e ka të drejtën e patjetërsueshme për të vërtetën lidhur me ngjarjet dhe rrethanat e kaluara që kanë çuar në shkeljet sistematike dhe në kryerjen e krimeve.”*<sup>41</sup> Këto parime u shërbejnë shteteve në zbatimin strategjik të drejtësisë tranzicionale në përpjekjet dhe obligimet e një shteti për të luftuar mosndëshkueshmërinë dhe të drejtën për të vërtetën.

Rëndësia e së vërtetës në një shoqëri pas konfliktit është e lidhur ngushtë me demokratizimin dhe transparencën. Pas përfundimit të mizorive ekziston një konsensus i përgjithshëm që shoqëria demokratike, e posaçërisht viktimat, meritojnë ta mësojnë krejt të vërtetën se çka ka ndodhur gjatë periudhës së luftës apo regjimit diktatorial. Në veçanti, e drejta e familjeve të personave të zhdukur për ta ditur të vërtetën është e garantuar me Protokollin shtesë të Konventave të Gjenevës<sup>42</sup> e 12 gushtit 1949, në nenet 32, 33 dhe 34. Gjithashtu, të drejtën për ta ditur fatin e personave të zhdukur me forcë e garanton edhe Konventa Ndërkombëtare për

---

<sup>41</sup> <http://derechos.org/nizkor/impu/principles.html>

<sup>42</sup> Konventat e Gjenevës nga 12 gushti 1949 dhe Protokollet shtesë nga 1977 dhe 2005. E qasshme në: <https://ckrm.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/ZENEVSKI%20KONVENCII%20%20NA%20ALBANSKI%20%202019%2011%202019%20vnatresni%20strani.pdf>

Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja e Dhunshme, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, me Rezolutën 47/133.<sup>43</sup>

Megjithatë, koncepti i së drejtës për të ditur, në kuadër të Drejtësisë Tranzicionale, është shumë më gjithëpërfshirës sesa çështja e personave të zhdukur. Shoqëritë pas konfliktit kanë të drejtë të dinë edhe për shkeljet e tjera masive të të drejtave të njeriut, edhe për rrethanat politike, sociale, kulturore, por edhe ekonomike, që kanë sjellë tek këto shkelje. Për t'i trajtuar të gjitha këto çështje, parashihen mekanizmat për gjetjen e së vërtetës, e të cilët zakonisht quhen Komisionet e së Vërtetës. Komisionet e së Vërtetës janë mekanizma zyrtarë që krijohen për t'i hetuar shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, krimet e luftës apo shkeljet e tjera serioze që kanë ndodhur në një periudhë të caktuar dhe janë kryer nga një regjim represiv apo nga grupe të ndryshme të armatosura. Këto komisione mund të kenë mandat ta bëjnë identifikimin edhe të shkaqeve dhe të pasojave të këtyre shkeljeve. Komisionet e së Vërtetës janë mekanizma të cilët duhen krijuar nga shteti, janë trupa ad-hoc dhe të kufizuar në kohë, të përkohshëm si dhe janë të orientuar drejt viktimës. Deri më tani janë më së 40 komisione të cilat janë krijuar në vende të ndryshme të botës.

Përveç mekanizmave institucionalë, në realizimin e së drejtës për të ditur, mund të kontribuojnë edhe aktorë të tjerë, siç janë: shoqëria civile, academia, media, komuniteti i artistëve, por edhe individë të tjerë.

Më poshtë do të trajtohen nismat institucionale dhe të shoqërisë civile për të kontribuar në zbatimin në praktikë të së drejtës për të ditur.

### **Nismat institucionale**

Deri më tani, Kuvendi i Kosovës konsiderohet të mos ketë luajtur rol aktiv në çështjet që kanë të bëjnë me Drejtësinë Tranzicionale, ndonëse vazhdimisht ka bërë thirrje për më shumë përgjegjësi nga ekzekutivi.<sup>44</sup> Disa nga çështjet që Kuvendi i ka trajtuar, janë: çështja e personave të zhdukur dhe çështjet e të kthyerve dhe të bashkësive, të cilat janë mandat i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazisë Gjinore, Personave të Zhdukur dhe Peticioneve. Megjithatë nuk është zhvilluar ndonjë strategji e as ndërmarrë ndonjë masë e veçantë për ta hapur debatin në Kuvend për çështjen e personave të zhdukur. Kuvendi ka qenë shtytës për funksionalizimin e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur.<sup>45</sup> Edhe pse ky komision është krijuar menjëherë pas luftës, ai ka marrë kompetenca substanciale vetëm pas sjelljes së Ligjit nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur<sup>46</sup>, në vitin 2011. Neni 8 i këtij ligji i jep kompetenca Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur të udhëheqë, mbikëqyr dhe bashkërendojë me institucionet, me organizatat ndërkombëtare dhe me aktorë të tjerë, në lidhje me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur si rezultat i luftës në Kosovë, pavarësisht

---

<sup>43</sup> Kombet e Bashkuara. Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë. E qasshme në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/international-convention-protection-all-persons-enforced>

<sup>44</sup> KIPRED (2009). "Drejtësia Tranzicionale në Kosovë - Punim Diskutues". E qasshëm në: [http://www.kipred.org/repository/docs/Drejt%C3%ABsia\\_tranzicionale\\_n%C3%AB\\_Kosov%C3%AB\\_\\_908851.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Drejt%C3%ABsia_tranzicionale_n%C3%AB_Kosov%C3%AB__908851.pdf)

<sup>45</sup> Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur. Më shumë informata në: <https://kryeministri.rks-gov.net/zyra-e-kryeministrit/zyrat/komisioni-qeveritar-per-persona-te-zhdukur/>

<sup>46</sup> Ligji nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2765>

përkatësisë etnike, religjionit apo statusit ushtarak dhe civil. Edhe pse ky komision dhe institucionet e tjera kompetente, vendore dhe ndërkombëtare, kanë ndërmarrë veprime për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, megjithatë ka ngecje. Përveç mungesës së informacioneve për lokalizimin e lokacioneve të varrezave masive apo individuale, ku mund të jenë varrosur trupat e personave të zhdukur, ka edhe një ngecje në identifikimin e trupave të cilët janë gjetur, por nuk po rezultojnë pozitiv në analizat e ADN-së. Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur do të duhej të ishte më këmbëngulës ta zgjidhte fatin e mbetjeve mortore të rreth 300 personave që gjenden në Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Në lidhje me të drejtën për të ditur, ka pasur edhe nisma të tjera institucionale, e njëra ndër më të rëndësishmet ka qenë themelimi i Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës.

**Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës** ishte krijuar me një vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në vitin 2011, dhe ky institut kishte funksionuar deri në vitin 2018 kur ishte shuar me një vendim tjetër të ministrit të Drejtësisë të asaj kohe, i cili kishte themeluar një Departament për Drejtësi Tranzicionale, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Edhe pse Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës kishte funksionuar për më shumë se 6 vjet dhe kishte nxjerrë një numër të publikimeve të cilat nuk ofronin një narrativ gjithëpërfshirës mbi krimet e kryera gjatë luftës. Disa nga publikimet e Institutit, janë: “Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998/99”, me autor prof. dr. sc. Fejaz Drançolli; “Kundër harresës – Gjenocidi i Serbisë në Kosovë 1998-1999”, me autore mr. sc. Fetnete Ramosaj; “Plaçkitja dhe Shkatërrimi i Fondit Arkivor të Kosovës nga Serbia, para dhe gjatë luftës 1998-1999”, nga autori mr. sc. Baki Svirca.

Zyrtarët e këtij Instituti shpesh ishin prononcuar publikisht se Instituti nuk ka përkrahje të duhur dhe kanë mungesë të theksuar të resurseve për t’i shtrirë hulumtimet e tyre.<sup>47</sup>

**Departamenti për Drejtësi Tranzicionale dhe Departamenti për Mbështetje të Viktimave të Krimit, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë**, është themeluar në vitin 2018 dhe përfshin dy divizione, atë për Drejtësi Tranzicionale dhe Divizionin për Mbështetjen e Viktimave të Krimit. Divizioni për Drejtësi Tranzicionale i ka detyrat dhe përgjegjësitë, si më poshtë<sup>48</sup>:

- Identifikon, propozon dhe analizon politikat për fushën e Drejtësisë Tranzicionale;
- Asiston në hartimin e akteve ligjore, dokumenteve politike dhe strategjike në fushën e Drejtësisë Tranzicionale;
- Themelon dhe mirëmban bazën e të dhënave për dokumentimin e krimeve dhe të dëmeve të luftës;
- Mbledh nga institucionet publike dhe nga qytetarët të dhënat për dëmet e luftës;
- Koordinon procesin e vlerësimit financiar të dëmeve të luftës;

---

<sup>47</sup> Intervistë e z. Ismet Salihut: Ismet Salihu - Mbyllja e Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, 17.5.2019 - YouTube.

<sup>48</sup> Ministria e Drejtësisë (rks-gov.net)

- Në bashkëpunim me Departamentin Ligjor dhe Avokaturën Shtetërore, propozon politika dhe akte normative dhe mbështet veprimet ligjore lidhur me krimet dhe dëmet e luftës që nuk janë të natyrës penale.

Deri në fund të vitit 2022 nuk ka të dhëna publike nëse Divizioni për Drejtësi Tranzicionale ka zbatuar ndonjë aktivitet serioz në drejtim të realizimit të detyrave dhe të përgjegjësive të listuara më lart.

**Instituti për Krimet e Kryera Gjatë Luftës** shihet si një rithemelim i institutit të mëparshëm, që ishte shuar në vitin 2018. Nisma për themelimin e këtij instituti ishte ndërmarrë nga Qeveria dhe në qershor të vitit 2021 ishte takuar për herë të parë grupi punues për hartimin e legjislacionit për Institutin, grup i cili ka përfshirë edhe përfaqësues të shoqërisë civile. Përfaqësues të Qeverisë disa herë kanë deklaruar publikisht se do ta fuqizojnë këtë institut dhe do të ndajnë resurse të mjaftueshme për punën e këtij instituti, prandaj edhe do ta krijojnë me një ligj të veçantë e jo me vendim qeveritar, siç kishte ndodhur në të kaluarën. Më 14 shtator 2022 qeveria e ka votuar projektligjin për Institutin për Krimet e Kryera gjatë Luftës, projektligj i cili e definon këtë institut si agjenci në kuadër të Kryeministrisë. Ky projektligj është miratuar në leximin e parë në Kuvendin e Kosovës, më 7 tetor 2022.

**Komisioni i së Vërtetës dhe Pajtimit** ishte një nismë e ndërmarrë nga presidenti i Republikës së Kosovës, në vitin 2017. Me rastin e lansimit të nismës, ai kishte mbledhur përfaqësuesit më të lartë shtetërorë e institucionalë, përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare në Kosovë, shoqërinë civile, komunitetin e viktimave si dhe përfaqësuesit e bashkësive fetare, në konsultimin e parë publik për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin. Pas konsultimeve të tjera të vazhdueshme, në Ditën Kombëtare të Personave të Zhdukur, më 27 prill 2018 kishte sjellë një vendim për emërimin e ekipit përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin.<sup>49</sup> Ky grup punues kishte nëntë anëtarë, nga të cilët 5 ishin përfaqësues të shoqërisë civile. Mandati i tyre ishte të hartonin një dokument të quajtur akt normativ për themelimin e Komisionit. Ekipi përgatitor kishte publikuar Projektaktin Normativ, në janar të vitit 2020.<sup>50</sup> Megjithatë, me zgjedhjen e presidentit të ri të vendit, asnjë veprim në lidhje me themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin nuk është ndërmarrë dhe procesi i themelimit të tij ka stagnuar.

Duke pasur parasysh të gjitha nismat e lartcekura, mund të thuhet se institucionet e shtetit kanë ndërmarrë nisma në drejtim të realizimit të së drejtës së viktimave dhe të qytetarëve për ta ditur të vërtetën mbi të kaluarën, mirëpo asnjëra nga këto nisma nuk ka dhënë rezultatet e pritura. Ende është shumë larg hartimit të një narrativi zyrtar të saktë dhe gjithëpërfshirës mbi krimet dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut të ndodhura gjatë luftës në Kosovë.

<sup>49</sup> Vendim për Emërimin e Ekipit Përgatitor për Themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin. I qashtëm në: [https://president-ksgov.net/repository/docs/2019\\_07\\_26\\_094525\\_VENDIM\\_PER\\_EMERIMIN\\_E\\_EKIPIT\\_PERGATITOR\\_PER\\_THEMELIMIN\\_E\\_KOMISIONIT\\_PER\\_TE\\_VERTETEN\\_DHE\\_PAJTIMIN.pdf](https://president-ksgov.net/repository/docs/2019_07_26_094525_VENDIM_PER_EMERIMIN_E_EKIPIT_PERGATITOR_PER_THEMELIMIN_E_KOMISIONIT_PER_TE_VERTETEN_DHE_PAJTIMIN.pdf)

<sup>50</sup> Projektakti Normativ Nr. Xx/2020 për Komisionin për të Vërtetën dhe Pajtimin. I qashtëm në: <https://view.officeapps.live.com/op/view.aspx?src=https%3A%2F%2Fkonsultimet.rks-gov.net%2FStorage%2FConsultations%2F15-48-26-28012020%2FProjektakti-ne-tri-shtylla-28-janar-2020.DOCX&wdOrigin=BROWSELINK>

## Nismat e shoqërisë civile

Për dallim nga nismat zyrtare të institucioneve të vendit, shoqëria civile ka shkuar më larg në dokumentimin e krimeve të luftës, sidomos të viktimave të këtyre krimeve. Shumë organizata të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe mediat dhe individë, kanë ndërmarrë nisma të ndryshme në drejtim të hulumtimit të fakteve dhe nxjerrjes të së vërtetës mbi krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë.

**Libër Kujtimi i Kosovës** është një projekt, i cili zbatohet nga dy organizata: Fondi për të Drejtën Humanitare, me seli në Beograd, dhe Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë. Në kuadër të këtij projekti, këto dy organizata janë fokusuar në regjistrimin e të gjithë të vrarëve dhe të të zhdukurve gjatë dhe menjëherë pas luftës në Kosovë, respektivisht në periudhën kohore 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000. Qëllimi i këtij projekti është të publikohen narrativët për secilën jetë të humbur gjatë dhe menjëherë pas luftës në një seri prej 4 vëllimesh të librit. Libri i parë është publikuar në vitin 2011 dhe përmban tregimet për rrethanat e vrasjes apo zhdukjes së mbi 2000 personave, të cilët janë vrarë apo zhdukur gjatë vitit 1998. Për më tepër, në ueb-faqen e këtij projekti ekziston lista prej 13.549 emrash të personave të vrarë dhe të zhdukur në periudhën 1998 -2000<sup>51</sup>, listë e cila përmban të dhëna të shumta mbi viktimat, siç janë: emri, mbiemri, emrat e prindërve, vendi dhe data e lindjes, vendi dhe data e vrasjes/zhdokjes etj. Kjo listë është një burim i jashtëzakonshëm i informatave, të cilat kontribuojnë shumë në zbardhjen e së vërtetës mbi krimet e luftës. Megjithatë, edhe kjo nismë i ka limitet e veta, sepse nuk është marrë me dokumentimin e kategorive të tjera të viktimave, siç janë: personat viktimat të dhunës seksuale, të plagosurit, viktimat e keqtrajtimit si dhe dëmet materiale gjatë luftës.

Libër Kujtimi i Kosovës është në shërbim të qëllimeve të ndryshme dhe të ndërlidhura. Përtej qëllimit primar të krijimit të memories kolektive bazuar në fakte dhe rimëkëmbjes sadopak të dinjitetit të viktimave, ai është po ashtu në shërbim të nismave të tjera të Drejtësisë Tranzicionale.

**Monografia “Krimet e Luftës në Kosovë 1998-1999”** është publikuar në vitin 2010 nga ana e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNU). Ky publikim në mbi 1000 faqe përmban kryesisht të dhënat e përgjithshme për personat e vrarë dhe të zhdukur dhe të dhënat komplete për viktimat në 11 komunat e Kosovës. Në promovimin e monografisë është theksuar: *“Të dhënat tregojnë se në Kosovë, gjatë kësaj periudhe janë vrarë gjithsej 8,214 veta, nga të cilët 6,804 ishin meshkuj, ndërsa 1,400 ishin femra. Prej tyre, 7,900 ishin civilë shqiptarë dhe 280 civilë serbë.”*<sup>52</sup>

**Krimet e Serbisë në Kosovë** është një publikim i autorit z. Jusuf Osmani, i botuar në dy vëllime nga Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës. Ky publikim përmban të dhëna mbi viktimat e luftës në Kosovë dhe, sipas autorit, ky publikim përmban të dhënat e 11 840 viktimave të luftës në periudhën janar 1999 – 12 qershor 1999.<sup>53</sup>

<sup>51</sup> Libri i Kujtimit - Lista e të vrarëve, e të zhdukurve dhe e të rënëve 1998 – 2000. I qasshëm në: [http://www.liberkujtimiikosoves.org/db/kkp\\_sq/index.html](http://www.liberkujtimiikosoves.org/db/kkp_sq/index.html)

<sup>52</sup> Radio Evropa e Lirë. “Krimet e luftës në monografi”. Publikuar më 18.6.2010. E qasshme në: <https://www.evropaelire.org/a/2075846.html>

<sup>53</sup> Panorama.al. “Botohet bilanci zyrtar i Luftës së Kosovës: 11 840 të vrarë”. Publikuar më 15.5.2013. I qasshëm në: <http://www.panorama.com.al/botohet-bilanci-zyrtar-i-luftes-se-kosoves-11-840-te-vrare/>



Përveç nismave që tentojnë ta bëjnë dokumentimin e plotë të një apo të disa kategorive të viktimave, janë zhvilluar edhe projekte të cilat kanë bërë dokumentimin e një numri të caktuar të viktimave, duke mos pasur qëllim dokumentimin e përgjithshëm. Njëri nga këto projekte është edhe “Njerëzit dhe Kujtime Flasin”<sup>54</sup>, i zbatuar nga OJQ-ja “Integra”. Në kuadër të këtij projekti, Integra ka prodhuar 59 filma narrativë dokumentarë. Në fakt këta filma përmbajnë rrëfimet e familjareve të të zhdukurve, e të cilët filma janë shfaqur në KTV.

Me dokumentimin e kategorisë së viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës merren disa organizata të shoqërisë civile, e që janë: Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), bashkë me organizatat partnere - Qendra për Promovimin e të Drejtëve të Grave, Medica Kosova dhe Medica Gjakova. Këto organizata janë duke e zbatuar projektin “Dokumentimi i krimeve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”<sup>55</sup>, në kuadër të të cilit projekt, deri në fund të vitit 2022, kanë dokumentuar 1060 raste të tilla.

Përveç nismave dhe projekteve të shoqërisë civile, të listuara më lart, dhe të disa nismave të tjera për dokumentim, të cilat nuk janë përmendur në këtë dokument, ka pasur edhe një nismë të organizatave joqeveritare për t’i shtyrë shtetet e dala nga ish-Jugosllavia të krijojnë një komision rajonal për të vërtetën. Kjo nismë është quajtura “Nisma për KOMRA”.<sup>56</sup>

Në vitin 2008, një koalicion i organizatave të shoqërisë civile nga vendet e rajonit, pas një numri të madh të konsultimeve me aktorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe komunitetin e viktimave, erdhi në idenë ta promovojnë themelimin e një komisioni rajonal të së vërtetës, i njohur si KOMRA (Komisioni rajonal për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut të kryera në ish-Jugosllavi nga viti 1991 deri në 2001). Koalicioni për KOMRA u themelua në kuadër të Forumit të Katërt për Drejtësi Tranzicionale, që u mbajt në tetor të vitit 2008 në Prishtinë, me vendim të 100 organizatave dhe shoqatave nga të gjitha shtetet e dala nga ish-Jugosllavia, që morën pjesë në këtë forum. Sipas anëtarëve të koalicionit, KOMRA do të synonte të mblidhte dhe t’i konsolidonte faktet për krimet e luftës të kryera, numrin e të vrarëve dhe të atyre që u zhdukën ose u mbajtën në burgje ose në kampe ndalimi gjatë konflikteve në rajon.

Tri vjet pas krijimit, koalicioni nxiti debatin social më gjithëpërfshirës që është ndërmarrë ndonjëherë në këtë rajon, duke përfshirë në procesin e konsultimit për mandatin e KOMRA-së 6 700 përfaqësues të shoqërisë civile, si: organizatat për të drejtat e njeriut, viktimat, familjet e viktimave dhe të pagjeturve, ish-refugjatë, veteranë, ish- të burgosur politikë, avokatë, artistë, shkrimtarë, gazetarë dhe individë të tjerë të shquar. Në tryeza të ndryshme pjesëmarrësit shprehën sugjerimet dhe pikëpamjet e tyre për mandatin e këtij organi rajonal ndërshtetëror, i cili do të duhej krijuar për të zbuluar dhe shpërndarë fakte rreth krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të rënda të të drejtave të njeriut, fakte si për viktimat, ashtu edhe për autorët. Janë mbajtur 128 takime lokale dhe rajonale, si dhe një numër të forumeve ndërkombëtare për Drejtësinë Tranzicionale.

---

<sup>54</sup> Integra, e qasshëm në: <https://peopleandmemories.org/sq/>

<sup>55</sup> Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT). “Dokumentimi i krimeve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë”. I qasshëm në: <http://pointmedia.al/krcrdokumentimi/dokumentimi2/>

<sup>56</sup> RECOM – Reconciliation Network. <https://www.recom.link/en/what-is-the-coalition-for-recom-2/>



Përveç kësaj, mbi gjysmë milioni qytetarë nga ish-Jugosllavia nënshkruan peticionet që bënin thirrje për një komision rajonal të së vërtetës, 120 000 vetëm në Kosovë. Procesi qysh nga atëherë ka ngecur.

## **E drejta në reparacion**

E drejta për dëmshpërblim – përfshin masat të cilat shteti obligohet t’i aplikojë për viktimat, për familjet e tyre dhe për komunitetet, ashtu që ta lehtësojë rikthimin në një gjendje të paktën të përafërt me atë që ekzistonte para konfliktit ose shkeljeve. “*Kjo e drejtë i referohet masave për korrigjimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut duke ofruar përfitime materiale dhe simbolike për viktimat, familjet e tyre dhe komunitetet e prekura.*”<sup>57</sup> Kompensimi mund të bëhet për dëmtim fizik ose mendor dhe për humbje të mundësive, të cilat lidhen me punësimin ose arsimimin, apo edhe në formën e rehabilitimit, sikur: kujdesi mjekësor, rivendosjen e dinjitetit për krimet e kryera kundër integritetit moral dhe seksual dhe nëpërmjet njohjes së përgjegjësisë në formën e kërkimfaljes publike dhe masave për ta ndërtuar paqen e qëndrueshme dhe pajtimin. Dëmshpërblimi duhet të jetë adekuat, efektiv, i shpejtë dhe proporcional me peshën e shkeljeve dhe dëmin e pësuar. Aktorët shtetërorë duhet të sigurojnë që individët të kenë qasje efektive në mjetet juridike dhe në dëmshpërblimet e detyrueshme, si udhëzim i përgjithshëm.

E drejta për reparacione përfshin masat të cilat shteti obligohet t’i aplikojë për viktimat, për familjet e tyre dhe për komunitetet, ashtu që t’i kontribuojnë një forme të njohjes simbolike të ndjenjës së humbjes së tyre, e cila është e nevojshme si pjesë e shërimit nga traumat e luftës dhe të ofrojë drejtësi dhe kompensim për humbjet që janë shkaktuar. Kjo e drejtë ua mundëson viktimave ta ushtrojnë të drejtën e tyre për të korrigjuar dhe është një kontribut i rëndësishëm për ata që i mbajnë mend. Në këtë drejtim, reparacionet janë thelbësore për paqen sociale, për stabilitetin dhe për çdo mekanizëm apo agjendë të ndërtimit të paqes pas konfliktit.<sup>58</sup>

Nga ana tjetër, reparacionet bëhen të domosdoshme në shoqëritë ku konflikti i armatosur ka ndikuar në masë të madhe në grupet më të ndjeshme, të varfra dhe të rrezikuara të shoqërisë, ashtu që viktimat të mundë ta rikthejnë dinjitetin e tyre, ta rifillojnë jetën e tyre dhe të jenë pjesë e barabartë e shoqërisë. Kjo e bën të drejtën për dëmshpërblime një prej dimensioneve më konkrete të Drejtësisë Tranzicionale karshi viktimave të konfliktit.

Në të kaluarën, shtetet të cilat kanë shkaktuar krime lufte ndaj civilëve kanë marrë përgjegjësinë për të ofruar reparacione për viktimat e këtyre krimeve. Shembulli më i mirë është Gjermania, e cila edhe sot paguan reparacione për viktimat e holokaustit. Izraeli ka negociuar me Gjermaninë Perëndimore për reparacionet. Në bazë të marrëveshjes, Gjermania Perëndimore do të paguante 100 milionë dollarë për dëmshpërblimet individuale, ndërsa Izraeli do të merrte 745 milionë dollarë. “*Pas marrëveshjes fillestare, puna e reparacioneve u*

---

<sup>57</sup> Fondi për të Drejtën Humanitare (2022). Towards Transitional Justice Strategy for Kosovo. I qasshëm në: <https://hlc-kosovo.org/storage/app/media/Strategjia%202022/TOWARDS%20A%20NATIONAL%20TRANSITIONAL%20JUSTICE%20STRATEGY%20FOR%20KOSOVO.pdf>

<sup>58</sup> Fondi për të Drejtën Humanitare (2016). “Reparacionet e Luftës për Viktimat Civile: Cila është Qasja për Komunitete?” E qasshme në: [https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Animacionet/HLC\\_Report\\_final%20REPARACIJE%20alb.pdf](https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Animacionet/HLC_Report_final%20REPARACIJE%20alb.pdf)

zgjerua. *Për shembull, në vitin 1988, Gjermania miratoi para në mënyrë që të mbijetuarit e Holokaustit të merrnin 290 dollarë në muaj për pjesën tjetër të jetës së tyre.*<sup>59</sup>

Në fakt, Rezoluta mbi parimet dhe udhëzimet themelore mbi të drejtën për një mjet juridik dhe reparacion për viktimat e shkeljeve të rënda të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, obligon shtetet të ofrojnë reparacione për viktimat e shkaktuar nga shteti. Parimi X i kësaj rezolute, me titullin: “Dëmshpërblimi për dëmin e pësuar”, në një pjesë të saj thekson: “*Në përputhje me ligjet e tij të brendshme dhe detyrimet ligjore ndërkombëtare, një shtet do të sigurojë dëmshpërblim për viktimat për veprime ose mosveprime që mund t’i atribuohen shtetit dhe që përbëjnë shkelje të rënda të ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut ose shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare.*”<sup>60</sup>

Pa marrë parasysh këtë instrument të Kombeve të Bashkuara dhe praktikat e mëhershme nga vendet e tjera, Serbia deri më tani nuk e ka ndërmarrë asnjë hap në drejtim të ofrimit të reparacioneve adekuate, efektive dhe në proporcion me peshën e shkeljeve dhe të dëmeve të shkaktuara ndaj viktimave në Kosovë, e që janë shkaktuar si pasojë e veprimeve të drejtpërdrejta të agjentëve shtetërorë të Serbisë, siç janë policia dhe ushtria e saj.

Në Kosovë, menjëherë pas përfundimit të luftës, ka pasur përpjekje të siguroheshin reparacionet për komunitetet e goditura nga lufta. Edhe pse është e vështirë të bëhet një hartëzim i reparacioneve materiale që janë siguruar për rindërtimin e shtëpive, mund të thuhet se një numër shumë i madh i organizatave, i institucioneve dhe i fondacioneve ndërkombëtare kanë kontribuar në rindërtimin e shumë shtëpive dhe t’u sigurohej kulm mbi kokë qytetarëve të Kosovës. Meqenëse në përputhje me standardet ligjore ndërkombëtare, të afërmit e viktimave, si personat e zhdukur, ashtu edhe ata të vrarë nga konflikti i armatosur në Kosovë, kanë të drejtë në reparacione adekuate dhe efektive, autoritetet e Kosovës kanë filluar të hartojnë korniza ligjore për ta rregulluar këtë çështje.

### **Reparacionet (kompensimet) materiale**

Dokumenti i parë i cila ka tentuar ta garantojë dhe ta zbatojë të drejtën për dëmshpërblim në Kosovë është Rregullorja nr. 2000/66 e UNMIK-ut “Mbi përfitimet e invalidëve të luftës në Kosovë dhe për më të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë”.<sup>61</sup> Ajo është pasuar në vitin 2006 me Ligjin nr. 2/L-02 i hartuar dhe i miratuar nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës. Ky ligj ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2007, me qëllim të rregullimit të statusit dhe të të drejtave të familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve dhe të pjesëtarëve të UÇK-së, si dhe të familjeve të viktimave civile të luftës, deri në vitin 2012.

<sup>59</sup> E qasshme në: [www.mnchurches.org/blog/2021/02/18/holocaust-survivors-receive-german-reparations-day](http://www.mnchurches.org/blog/2021/02/18/holocaust-survivors-receive-german-reparations-day)

<sup>60</sup> E qasshme në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/basic-principles-and-guidelines-right-remedy-and-reparation>

<sup>61</sup> Rregullorja nr. 2000/66 e UNMIK-ut “Mbi përfitimet e invalidëve të luftës në Kosovë dhe për më të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë. E qasshme në: <http://www.unmikonline.org/regulations/2000/reg66-00.htm>

Pas konsolidimit të institucioneve të Republikës së Kosovës është miratuar dhe ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2012 Ligji nr. 04 / I-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjet e tyre”.<sup>62</sup> Ky ligj ka zëvendësuar tërë legjislacionin e mëparshëm dhe ka shërbyer si legjislacion kryesor për dëshmipërbllim të viktimave të luftës në Kosovë. Ndër të tjerash, ky ligj ka përcaktuar statusin, përkrahjen financiare, të rregulluar përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë e ndryshme të pjesëmarrësve në konfliktin në Kosovë. Ligji rregullon, nga njëra anë, të drejtat e dëshmorëve dhe të personave të zhdukur të UÇK-së, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të UÇK-së dhe të anëtarëve të tyre të familjes së ngushtë, dhe, nga ana tjetër, statusin dhe të drejtat e viktimave civile dhe të familjeve të tyre. Me nismën e organizatave të grave, ky ligj është plotësuar në muajin mars të vitit 2014, me Ligjin nr. 04/L-172<sup>63</sup>, me të cilin njihen dhe pranohen si kategori e veçantë e viktimave edhe personat viktimë të dhunës seksuale gjatë luftës dhe rregullon të drejtat e tyre.

Ligji i cili bën rregullimin dhe përcaktimin e statusit dhe është shumë i rëndësishëm edhe në rregullimin e sistemit të reparacioneve për një kategori të veçantë të viktimave është edhe Ligji nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur”<sup>64</sup>, i cili është miratuar në muajin gusht të vitit 2011, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe të interesave të personave të zhdukur dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Ky ligj është bazë për themelimin e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, i cili, ndër të tjerash, është përgjegjës për krijimin e Regjistrisë Qendrore për Personat e Zhdukur.

Dy ligjet e lartcekura marrin parasysh dy korniza të ndryshme kohore për dy kategori të viktimave, atë të personave të zhdukur dhe të viktimave civile të luftës. Në të dyja ligjet, personi civil i zhdukur përkufizohet: *“Personi vendndodhja e të cilit është e panjohur për familjarët e tij/saj dhe i cili në bazë të informacionit të besueshëm, është zhdukur në periudhën mes 1.01. 1998 dhe 31.12. 2000, si pasojë e luftës në Kosovë në vitet 1998-1999.”* Pra statusin e personave të zhdukur e fitojnë të gjithë personat që janë zhdukur nga 1.1.1998 deri më 31.12.2000. Ndërsa Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjet e tyre dhe viktimat e dhunës seksuale, viktimën civile të luftës e përkufizohet si: *“Personi i cili është vrarë apo është plagosur, nga forcat e armikut, e më vonë ka vdekur, brenda periudhës 27.02.1998 deri me 20.06.1999, si dhe personat që kanë pësuar si pasojë e luftës brenda tri (3) viteve që nga përfundimi i luftës nga mjetet shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës.”* Pra, ky ligj merr parasysh periudhën kohore vetëm nga 27.2.1998 deri më 20.6.1999. Po i njëjti ligj ua garanton anëtarëve të ngushtë të familjeve edhe të personave të zhdukur edhe të atyre të vrarë, pensionin familjar, si masë e reparacionit.

---

<sup>62</sup> Ligji nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2793>

<sup>63</sup> Ligji nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të Tyre. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9436>

<sup>64</sup> Ligji nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2765>

Në këto dy ligje parashihen dy korniza të ndryshme kohore, në varësi të faktit nëse trupi i një viktime është identifikuar (pra, nëse i përket kategorisë së të vrarëve apo ende është i zhdukur). Në këtë mënyre ka raste kur së njëjtës viktimë, një herë si person i zhdukur pas datës 20 qershor 1999, i njihet statusi i personit të zhdukur, ndërsa pasi të identifikohen mbetjet mortore të tij, të cilat i dorëzohen familjes, nuk i njihet statusi i viktimës civile të luftës, sepse është jashtë kornizës kohore që e njih ligji. Si pasojë e kësaj mospërputhje, edhe familja e ngushtë e viktimës automatikisht e humb të drejtën për pension familjar.

Për qëllime të këtij raporti, Zyra për Komunikim me Publikun e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), përmes postës elektronike ka ofruar të dhëna statistikore mbi përfituesit e pensioneve familjare, si masë e reparacionit për familjarët e ngushtë të viktimave civile të luftës dhe të personave të zhdukur. Sipas këtyre të dhënave, 3 632 familje që përfitojnë pension në emër të familjarëve të tyre - viktimave civile të luftës, nga ta janë 3 596 shqiptarë, 23 serbë dhe 13 të tjerë. Në emër të familjarëve të tyre - persona civilë të zhdukur, pension familjar përfitojnë 306 familje, prej tyre 248 shqiptarë, 54 serbë dhe 4 të tjerë.

Sipas të dhënave preliminare nga Libër Kujtimi i Kosovës, të nxjerra nga lista e të gjitha viktimave të luftës së Kosovës<sup>65</sup>, rezulton se rreth 640 persona janë viktimave civile, që janë vrarë si pasojë e luftës pas datës 20 qershor 1999, ndërsa familjet e tyre nuk janë të kualifikuara të aplikojnë për reparacione në bazë të ligjit. Në bazë të Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjet e tyre dhe viktimat të dhunës seksuale, familjet e viktimave të lartcekura nuk kanë të drejtë për reparacione, përderisa familjarët e personave të zhdukur në të njëjtën periudhë kanë të drejtë. Prandaj është e rëndësishme të harmonizohet kohështrirja për të gjitha kategoritë e viktimave.

Autoritetet në Kosovë janë kujdesur të zhdëmtohet përmes kompensimeve materiale edhe një kategori tjetër e viktimave të luftës, fjala është për ish- të burgosurit politikë. Gjatë tërë periudhës së komunizmit në ish-Jugosllavi, e edhe gjatë viteve të nëntëdhjeta, më së shumti të burgosur politikë ka pasur shqiptarë të Kosovës. Vetëm në vitin 1999, pas nënshkrimit të marrëveshjes së Kumanovës, nga burgjet e Kosovës janë dërguar në Serbi rreth 2 100 të burgosur shqiptarë<sup>66</sup>, shumica civilë. Ka pasur edhe një numër të vogël të femrave si dhe të mitur. Të gjithë, pa dallim, kanë qenë subjekt i keqtrajtimit dhe shumë nga ta kanë qenë të privuar nga të drejtat e tyre si të burgosur, duke përfshirë edhe të drejtën për gjykim të drejtë. Për ta kompensuar këtë kategori të viktimave, si dhe ish- të burgosurit politikë nga periudhat e mëhershme, në vitin 2010 është miratuar Ligji nr. 03/L-95 për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë.<sup>67</sup> Në bazë të këtij ligji, personat që kanë fituar statusin e të burgosurit politik kanë të drejtë të zhdëmtohen materialisht, me të holla, si dhe mund të përfitojnë benificione të tjera që kanë të bëjnë: me përparësi në punësim, me përparësi për bursa dhe për vendosje të fëmijëve të tyre në konvikte, me përparësi në shfrytëzimin e teksteve shkollore pa pagesë, me lehtësi tatimore dhe doganore për mjetet dhe pajisjet e

<sup>65</sup> Libër Kujtimi i Kosovës, Fondi për të Drejtën Humanitare, i qasshëm në: [www.kosovskaknjigapamcjenja.org/?page\\_id=48&lang=zh](http://www.kosovskaknjigapamcjenja.org/?page_id=48&lang=zh)

<sup>66</sup> Memorandum për të burgosurit politikë shqiptarë në Serbi. I qasshëm në: <http://www.hlc-rdc.org/?p=13329&lang=de>

<sup>67</sup> Ligji nr. 03/L-95 për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2738>

domosdoshme për rehabilitimin e tyre shëndetësor, me lehtësi për shpenzimet e transportit me mjetet e transportit publik etj. Ky ligj rregullon edhe themelimin e Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë, i cili edhe është kompetent për zbatimin e këtij ligji.

Nga tërë ajo që u tha më lart mund të nxirret konkluzioni se autoritetet në Kosovë kanë bërë përpjekje solide të krijonin mekanizma dhe të ndërmerrnin masa që viktimat e luftës të merrnin kompensim materiale për vuajtjet dhe humbjet që i kanë pësuar gjatë luftës. Kjo pa dyshim se ndikon edhe në njohjen dhe pranimin simbolik të vuajtjeve të tyre, gjë që është e rëndësishme për vetë viktimën.

### **Reparacionet simbolike dhe memorialet**

Në teorinë e Drejtësisë Tranzicionale, me reparacionet simbolike shpesh nënkuptohet ngritja e memorialeve. Megjithatë, reparacionet simbolike përfshijnë një gamë më të gjerë të masave, të politikave dhe të veprimeve që aktorët shtetërorë ndërmarrin në mënyrë që të njihen dhe të pranohen viktimat dhe vuajtjet e tyre dhe të kthehet dinjiteti i viktimave. Masat dhe veprimet me të zakonshme që janë zbatuar në shoqëritë e dala na konfliktet apo nga regjimet diktatoriale kanë përfshirë kërkimfaljen formale, caktimin e ditëve të përkujtimit për viktimat apo për kategori të veçanta të viktimave, emërtimin e rrugëve, të shesheve apo të hapësirave publike në nderim të viktimave, ngritja e memorialeve, ndërtimi i muzeve etj. Të gjitha këto ndikojnë në procesin e ruajtjes së kujtesës historike dhe në mbrojtjen e vlerave demokratike dhe respektimin e të drejtave të njeriut, ndërtimin e besimit në institucionet qeveritare, ruajtjen e paqes, ndërtimin e marrëdhënieve të reja dhe rivendosjen e marrëdhënieve të vjetra shoqërore.

Procesi i memorializimit lidhet drejtpërdrejt me rolin e shtetit për të siguruar satisfaksionin e viktimave të shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe për ta mbrojtur kujtesën historike, për t'i nderuar viktimat, për ta parandaluar revizionizmin dhe mohimin e së kaluarës dhe parandalimin e përsëritjes së shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Në mënyrë që të parandalohet kundër efekti i memorialëve, është e rëndësishme të zhvillohen konsultimet dhe të bëhet edhe përfshirja e grupeve të ndryshme të viktimave dhe të komuniteteve të prekura gjatë gjithë procesit të memorializimit.

Muzetë dhe qendrat e dokumentacionit luajnë gjithashtu një rol në përmbushjen e funksioneve të kërimit të së vërtetës. Monumentet përkujtimore dhe muzetë paraqesin një rrëfim autoritar për të kaluarën dhe shërbejnë si një depo e informacioneve dhe burime parësore për një periudhë të caktuar historike. Si shumë masa të tjera të Drejtësisë Tranzicionale, memorialet, muzetë dhe qendrat e dokumentacionit mund të nxisin shërimin social në shumë mënyra të tjera duke nderuar jetën e viktimave, duke njohur përvojat e të mbijetuarve të konfliktit dhe duke riparuar vuajtjet e kaluara.<sup>68</sup>

Për dallim prej reparacioneve materiale, autoritetet në Kosovë kanë bërë dukshëm më pak në hartimin e strategjive dhe të politikave për t'i zbatuar nismat e ngritjes së reparacioneve simbolike. Shumica dërmuese e këtyre masave janë tkurrur në ngritjen e memorialeve, të

---

<sup>68</sup> Më shumë informata në: <https://www.ushmm.org/genocide-prevention/simon-skjodtcenter/work/ferencz-international-justice-initiative/transitional-justice/truth-seeking>



busteve dhe të përmendoreve që shënojnë ditë të caktuara dhe nderojnë kategori të fragmentuara të viktimave.

Në fakt, shumica dërrmuese e memorialeve në Kosovë janë ngritur me nisma private dhe me fonde private, dhe si të tilla nuk kanë kaluar në një proces të vlerësimit profesional dhe urban. Duket se në shumë raste nuk janë marrë as lejet përkatës nga institucionet komunale. Si pasojë, memorialet janë ngritur në mënyrë kaotike, pa një plan të paracaktuar dhe nuk kanë asnjë ndërlidhje dhe nuk komunikojnë me njëra-tjetrën. Vëmendje larg më të madhe në memoriale kanë zënë figurat ushtarake, pjesëtarët e rënë të UÇK-së, ndërsa më pak viktimat civile të luftës. Doktor i Filozofisë, prof. Bekim Baliqi, në një tekst mbi kujtesën kolektive, shprehet: *“Përmendoret e monumentet publike dhe rrëfimet rreth luftës në Kosovë, janë të përqendruara kryesisht në heroizmin e ushtarëve të rënë për liri dhe sakrificës së shumtë në luftën çlirimtare.”*<sup>69</sup> Gjithashtu femrat nuk kanë zënë vendin e merituar në fushën e memorialeve. Memoriali “Heroinat” është ngritur tek në vitin 2015 dhe u kushtohet viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Një dukuri tjetër që vërehet tek memorialet është edhe qasja jogjithëpërfshirëse. Janë fare të pakta memorialet e ngritura e të cilat përfshijnë viktimat e etnive të ndryshme, edhe në rastet kur viktimat e etnive të ndryshme kanë humbur jetën tragjikisht si pasojë e luftës në të njëjtin incident.

Për sa i përket infrastrukturës ligjore për rregullimin e ngritje së memorialëve, është krijuar një mekanizëm, i cili quhet “Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale në Kosovë”, i cili është krijuar me Ligjin nr. 04/L-140<sup>70</sup>, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2013. Kjo agjenci është përgjegjëse për projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e komplekseve memoriale në tërë territorin e Kosovës. Edhe pse agjencia nuk ka mundur t’i vërë nën mbrojtje dhe menaxhim të gjitha memorialet që shënojnë ngjarjet e viteve 1998 dhe 1999 në Kosovë, megjithatë ka bërë një punë shumë të mirë në regjistrimin e tyre. Deri më tani i ka regjistruar mbi 1 300 memoriale dhe i ka shënuar në mënyrë digjitale. Ky regjistër në formën e hartës interaktive është i qasshëm në ueb-faqen e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale.<sup>71</sup>

Memoriali i vetëm i cili është rregulluar me ligj të veçantë është Kompleksi Memorial “Adem Jashari”. Ligji nr. 06/L-059<sup>72</sup> për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz ka hyrë në fuqi në vitin 2018 dhe rregullon në detaje gjithçka që ndërlidhet me këtë kompleks memorial. Ky ligj është një shembull i mirë se si duhen rregulluar komplekset memoriale.

Përveç memorialeve të ngritura në Kosovë në nderim të viktimave të luftës, ka pasur edhe nisma të tjera për shënimin e ditëve të rëndësishme në nderim të viktimave dhe që konsiderohen si veprime në sferën e reparacioneve simbolike. Njëra ndër më të rëndësishmet është edhe Dita e Personave të Zhdukur. Me propozimin e 7 deputetëve, Kuvendi i Kosovës, në seancën e mbajtur më 8.2.2007, e ka shpallur 27 prillin si Ditën e të Pagjeturve të

<sup>69</sup> S’bunker. “Kujtesa kolektive dhe pushteti politik”. Publikuar më 10.11.2016. E qasshme në: <https://sbunker.net/op-ed/88311/kujtesa-kolektive-dhe-pushteti-politik/>.

<sup>70</sup> Ligji nr. 04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8657>

<sup>71</sup> Më shumë informata në: <https://amkmk.rks-gov.net/>

<sup>72</sup> Ligji nr. 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18130>

Kosovës.<sup>73</sup> Është përzgjedhur data 27 prill, sepse në atë datë të viti 1999, në fshatrat Mejë dhe Korenicë të komunës së Gjakovës kishte ndodhur masakra më e madhe nga forcat serbe ndaj shqiptarëve të Kosovës, ku nga këto dy fshatra dhe nga fshatrat përreth, 364 persona ishin vrarë, ndërsa trupat e tyre ishin bartur në varrezat masive në Serbi dhe viktimat ishin konsideruar të zhdukur për shumë vite. Nga viti 2007, 27 prilli shënohet me aktivitete të ndryshme në nderim të personave të zhdukur.

Edhe nga ana e shoqatave dhe e organizatave joqeveritare ka nisma për krijimin e memorialeve si formë e reparacioneve materiale. Ato mund të jenë fizike, virtuale apo të dyja në të njëjtën kohë. Më poshtë janë listuar disa nisma të tilla:

- “Muzeu Virtual i Refugjatëve”<sup>74</sup> është një përmbledhje e rrëfimeve të individëve, të cilët shpalosin përvojat e tyre gjatë periudhës sa ishin refugjatë si pasojë e luftës në Kosovë. Kjo platformë është krijuar në vitin 2021 nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.
- “Toka e Hidhur”<sup>75</sup> është një bazë interaktive e të dhënave, e cila përmban lokacionet e sakta të varrezave masive që janë zbuluar në territorin e ish- Jugosllavisë, duke përfshirë edhe Kosovën. Gjithashtu kjo bazë përmban edhe informacionet mbi identitetin e viktimave të gjetura në varrezat masive si dhe informacione të tjera. Edhe kjo platformë është krijuar në vitin 2021 nga BIRN-i.
- Ekspozita “Na ishte njëherë që kurrë mos qoftë” është një ekspozitë e cila është krijuar në nderim të 1 133 fëmijëve që kanë humbur jetën ose janë zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë. Ekspozita është fizike dhe virtuale dhe përmban gjësende të fëmijëve viktimë, murin me mbi 500 fotografi të fëmijëve viktimë të luftës, murin me emrat e të gjithë 1 133 fëmijëve si dhe elemente të tjera. Ekspozita gjendet në hapësirat e Qendrës së Dokumentimit të Kosovës dhe është krijuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë.

Në përgjithësi, institucionet shtetërore nuk kanë bërë mjaftueshme në fushën e memorializimit, si formë e reparacioneve simbolike. Memorialet janë ngritur pa kritere si pasojë e mungesës së një ligji, i cili do t’i përcaktonte kriteret dhe udhëzimet e sakta për ngritjen e memorialeve.

## **Garantimi i mospërsëritjes**

Reformat institucionale paraqesin procesin e rishikimit dhe të ristrukturimit të institucioneve shtetërore në mënyrë që ato t’i respektojnë të drejtat e njeriut, ta ruajnë shtetin e së drejtës dhe të jenë të përgjegjshëm ndaj publikut. Institucionet publike, sidomos ato të sigurisë, siç janë policia, ushtria dhe gjyqësori, zakonisht janë instrumentet e shkeljeve të rënda dhe sistematike të të drejtave të njeriut në shoqëritë të cilat përjetojnë konflikt ose regjim diktatorial. Kur tranzicioni drejt paqes dhe qeverisjes demokratike ndodh, reforma e thellë e

---

<sup>73</sup> Transkripti i seancës plenare të Kuvendit të Kosovës, mbajtur më 8.2.2007. I qasshëm në: [http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/2007\\_02\\_08%20Transkript%20i%20seanc%C3%ABs%20plenare.pdf](http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/2007_02_08%20Transkript%20i%20seanc%C3%ABs%20plenare.pdf)

<sup>74</sup> Muzeu i Refugjatëve Kosovë. Për më shumë shih: <https://museumofrefugees-ks.org/>

<sup>75</sup> Hartëzimi i Varreve Masive. Bitter Land. Për më shumë shih: <https://massgravesmap.balkaninsight.com/?lang=sq>

institucioneve të tilla është e domosdoshme dhe konsiderohet thelbësore për Drejtësinë Tranzicionale.

E drejta për garanci për mospërsëritje nënkupton obligimin e shtetit për të siguruar qeverisje të mirë dhe sundim të ligjit ashtu që të sigurojë që krimet që kanë ndodhur në të kaluarën të mos përsëriten. Për ta ofruar garancinë për mospërsëritje, shteti duhet t'i ndërmarrë një mori masash dhe veprimesh, e të cilat konsistojnë në:

- Çarmatimin, demobilizim dhe riintegrimin e strukturave paralele të sigurisë apo të ushtrisë guerile, nëse ka pasur një të tillë;
- Vetingun apo verifikim e personelit në strukturat e shtetit, duke përfshirë edhe zyrtarët civilë, dhe largimi nga shërbimi civil apo qeveritar në qoftë se dokumentohet se kanë pasur sjellje abuzive apo kanë qenë të korruptuar në të kaluarën;
- Reformat strukturore, në mënyrë që të promovohet legjitimiteti dhe integriteti i institucioneve përmes rritjes së llogaridhënies së të njëjtave ndaj qytetarëve;
- Transformimin e kornizave ligjore duke adaptuar/përfshirë standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (konventat dhe traktatet e ndryshme);
- Krijimin e trupave mbikëqyrës në institucione, sidomos të sigurisë, në mënyrë që të sigurohet llogaridhënia;
- Krijimin e programeve edukative mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, për zyrtarët publikë.

Në rastin e Kosovës, ndërmarrja dhe zbatimi i reformave institucionale në mënyrë që të garantohet mospërsëritja ka qenë shumë më e lehtë dhe më e thjeshtë sesa në vendet e tjera që kanë dalë nga lufta apo nga regjimi diktatorial/autoritar. Kjo për arsyen se administrata shtetërore, e cila ishte abuzive dhe diskriminuese ndaj qytetarëve, si dhe institucionet e sigurisë që kishin kryer shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, me marrëveshjen e paqes janë detyruar të largoheshin nga Kosova. Të gjitha institucionet shtetërore janë krijuar nga fillimi, prandaj edhe nuk ka pasur nevojë të ndërmerreshin reformat strukturore ose verifikimi (vetting). Gjithashtu, menjëherë pas përfundimit luftës në Kosovë, prania e institucioneve ndërkombëtare ka qenë shumë e madhe dhe për një kohë Kosova është administruar nga UNMIK-u dhe misioni i tij, si dhe organizatat e tjera ndërkombëtare kanë asistuar me themelimin e institucioneve vendore.

Megjithatë, edhe në Kosovë janë ndërmarrë masa për zbatimin e reformave institucionale, si masë për garantimin e mospërsëritjes, aty ku ka pasur nevojë.

Çarmatimi, demobilizimi dhe riintegrimi i pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ka qenë një proces i cili vlerësohet si shumë i suksesshëm, edhe pse në fillim ka pasur një rezistencë nga ana e udhëheqësve të UÇK-së që të kalonin nëpër këtë proces. Shumë shpejt është arritur një kompromis, i cili ka paraparë krijimin e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës, një trupë kjo e paarmatosur, e cila për nga ndërkombëtarët është parë si një trupë për intervenime humanitare, ndërsa nga vendorët është parë si një ushtri e ardhshme e Kosovës. Në këtë trupë janë integruar pjesëtarët e UÇK-së. Nga ana tjetër është iniciuar themelimi i Shërbimit Policor të Kosovës, ku është arritur një marrëveshje që deri në 50% e

pjesëtarëve të policisë do të ishin ish-ushtarë të UÇK-së.<sup>76</sup> Në këtë mënyrë shumica e pjesëtarëve të UÇK-së janë riintegruar në këto dy institucione, ndërsa një pjesë e vogël kanë kaluar nëpër trajnime të ndryshme për t'u aftësuar për shërbime të tjera civile. Megjithatë, pjesa më e madhe e pjesëtarëve të UÇK-së vullnetarisht janë çarmatosur dhe i janë kthyer jetës pa shprehur interesim të integroheshin në ndonjë institucion të sigurisë. Nga korriku deri në shtator të vitit 1999 ka ndodhur demobilizimi, çarmatimi dhe riintegrimi i UÇK-së.

Krijimi i trupave mbikëqyrës në institucione, sidomos të sigurisë, në mënyrë që të sigurohet llogaridhënia, në Kosovë është bërë në mënyrë të duhur. Pranë Policisë së Kosovës ekziston Inspektorati Policor i Kosovës, i cili pranon ankesa nga qytetarët dhe kryen inspektime të pjesëtarëve të policisë. Ky inspektorat ka faqen e vet në internet<sup>77</sup> dhe të dhënat në këtë faqe janë shumë transparente. Gjithashtu, secili qytetar mund të dërgojë ankesë përmes kësaj faqeje.

Në shtyllën e reformave institucionale në Kosovë ka ngecje të theksuara në zhvillimin e programeve të trajnimit të zyrtarëve civilë, sidomos të atyre në nivel lokal dhe të cilët janë të autorizuar t'u ofrojnë shërbime të ndryshme qytetarëve dhe të cilët nuk kanë njohuri të mjaftueshme mbi standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Transformimi i kornizave ligjore, si element i reformave institucionale, që garantojnë mospërsëritjen, është bërë në mënyrë të shkëlqyeshme në Kosovë. Neni 22 i Kushtetutës së Kosovës<sup>78</sup> (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) miraton zbatimin automatik të instrumenteve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut. Këto instrumente dhe marrëveshje ndërkombëtare janë si në vijim:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese;
- Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

---

<sup>76</sup> Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF) (2005). 'Disarmament, Demobilisation and Reintegration (DDR): Conceptual approaches, specific settings, practical experiences.' Working paper. [https://dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/RUFER\\_final.pdf](https://dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/RUFER_final.pdf)

<sup>77</sup> Inspektorati Policor i Kosovës, i qasshëm në: <https://ipk.rks-gov.net>

<sup>78</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës. E qasshme në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

Për më tepër, Kushtetuta parasheh se nëse këto instrumente bien ndesh me dispozitat e ligjeve të Kosovës, ato kanë prioritet.

## **Konstatimet dhe rekomandimet**

### **Konstatimet**

Avokati i Popullit konstaton se shteti nuk ka përmbushur obligimet e veta karshi viktimave në ofrimin e drejtësisë për krimet që janë kryer kundër tyre. Gjithashtu shteti nuk ka përmbushur obligimin e vet ndaj viktimave kur bëhet fjalë për mbledhjen dhe dokumentimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe kështu nuk është përmbushur e drejta për të ditur.

Në anën tjetër, shteti në masë të madhe ka përmbushur detyrimet e veta në ofrimin e reparacioneve materiale ndaj viktimave dhe ndërmarrjes së reformave institucionale me qëllim të garantimit të mospërsëritjes.

Në bazë të hulumtimeve të ndërmarra për përgatitjen e këtij raporti mund të arrihet në përfundimin se shteti i Kosovës ka ndërmarrë nisma ligjore dhe institucionale për t'i zbatuar mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale, por këto nisma nuk kanë qenë gjithmonë në harmonizim dhe as në bashkërenditje me njëra-tjetrën dhe si të tillë nuk kanë mundur të japin rezultate të dëshiruara. Prandaj, një ndër dështimet kryesore të shtetit të Kosovës në fushën e zbatimit të mekanizmave të Drejtësisë Tranzicionale është fakti se nuk ka qenë në gjendje, pa marrë parasysh përpjekjeve, që deri më tani të hartonte një strategji nacionale për Drejtësinë Tranzicionale, e cila do t'i harmonizonte të gjitha nismat ligjore dhe institucionale që të realizonte të drejtën e viktimave për drejtësi dhe reparacione si dhe të drejtën e shoqërisë për të ditur mbi të kaluarën. Nga ana tjetër, për shkak të kompetencave të kufizuara dhe për shkak të rrethanave politike, autoritetet kosovare shpesh nuk kanë qenë në pozitë t'i zbatonin masat nga fusha e Drejtësisë Tranzicionale.

Mungesa e kompetencave më së shumti është reflektuar në realizimin e **së drejtës për drejtësi**, respektivisht në ndjekjet dhe gjykimet penale për krime lufte. Që nga viti 1999 deri në vitin 2015, kompetencat ekskluzive për procedimin e lëndëve për krime lufte i kanë pasur misionet ndërkombëtare në Kosovë, së pari UNMIK-u e pastaj EULEX-i. Edhe pse gjyqtarët vendorë kanë qenë të përfshirë, si anëtarë të trupave gjykues, në proceset gjyqësore për krime lufte, megjithatë kryetarët e këtyre paneleve, si dhe shumica e anëtarëve të paneleve, kanë qenë ndërkombëtarë. Edhe aktakuzat janë përgatitur, ngritur dhe përfaqësuar në gjykatë nga ana e prokurorëve ndërkombëtarë. Megjithatë, edhe pas marrjes së kompetencave nga prokurorët dhe gjykatësit vendorë, ka pasur fare pak aktakuza të ngritura për krime lufte.

Edhe pse “Strategjia e Krimeve të Luftës” ka hyrë në fuqi në vitin 2019, ajo ende nuk ka dhënë rezultate. Ndoshta i vetmi element i strategjisë që është realizuar deri më tani është rritja e numrit të prokurorëve dhe të bashkëpunëtorëve profesionalë në Departamentin për Krime Lufte në PSRK. Gjithashtu kjo strategji nuk është zbatuar në pjesën që parasheh vendosjen e bashkëpunimit me Mekanizmin Rezidual për Tribunalet Ndërkombëtare dhe Prokuroritë në vendet e rajonit.

Bashkëpunimi me Mekanizmin Rezidual do të ishte tejet i rëndësishëm, sepse ky institucion e menaxhon bazën e të dhënave të Tribunalit Penal për ish-Jugosllavinë, ku ka dokumentacione masive, të mbledhur nga Prokuroria e këtij Tribunali për krimet e kryera në Kosovë. Nga ana tjetër, bashkëpunimi eventual me prokuroritë për krime të luftës, nga rajoni, me theks të



veçantë me atë të Serbisë, do ta hapte mundësinë për ndjekjen penale të atyre që kanë kryer krime lufte në Kosovë dhe jetojnë në Serbi.

Vërehet se viteve të fundit, të gjitha proceset gjyqësore për krime lufte në Kosovë zhvillohen ndaj kryerësve të krimeve të profilit të ulët, të cilët nuk kanë qenë përgjegjës kryesorë për ato krime. Kjo ndodh sepse organet e ndjekjes nuk mund të vijnë te përgjegjës kryesorë, shumica e të cilëve jetojnë në Serbi. Ideja që të tejkalohen këto probleme përmes gjykimeve në mungesë nuk duket të jetë zgjidhje ideale. Në fakt, përvoja e Kroacisë, e cila ka zbatuar për një kohë të gjatë gjykimet në mungesë, për krime lufte, tregon se gjykimet në mungesë mund ta sfidojnë seriozisht legjitimitetin e këtyre proceseve gjyqësore. Së paku në dy raste të cilat janë dërguar në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kjo gjykatë u ka dhënë të drejtë ankuesve, me arsyetimi se është shkelur neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e që është e Drejta për një proces të drejtë gjyqësor. Këto dy raste janë rasti Sanader<sup>79</sup> dhe rasti Pozder.<sup>80</sup>

Shteti i Kosovës gjithashtu ka dështuar ta realizojë **të drejtën për të ditur**. Njëra ndër çështjet më të ndjeshme në fushën e së drejtës për të ditur janë personat e zhdukur. E drejta e familjeve të personave të zhdukur për ta ditur të vërteten mbi fatin e më të dashurve të tyre është garantuar edhe me Protokollin shtesë të Konventave të Gjenevës si edhe me Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja e Dhunshme. Sidoqoftë, ende sot nuk dihet fati i mbi 1 600 personave të zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë. Sigurisht, procesi i gjurmimit për lokacionet e varrezave masive është tejet i ndërlikuar, por së paku institucionet e shtetit të Kosovës do të duhej të ishin më efikase dhe së paku ta zbardhnin identitetin e rreth 300 mbetjeve mortore që gjenden në morgun e Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML) në Prishtinë. Po të trajtohej kjo çështje me kujdes dhe të identifikoheshin këta trupa, atëherë numri i përgjithshëm i personave të zhdukur do të binte për gati 20%.

Edhe në mbledhjen e fakteve për krimet e kryera gjatë luftës, shteti i Kosovës ka dështuar. Janë krijuar mekanizma të cilët nuk e kanë zbatuar misionin e tyre, siç është rasti me Institutin për Hulumentimin e Krimeve të Luftës dhe Departamentin për Drejtësi Tranzicionale. Mekanizmi i parë është shuar, ndërsa i dyti ende nuk ka dhënë ndonjë rezultat dhe nuk ka informata ta ketë filluar zbatimin e disa prej detyrave të tij, siç është themelimi dhe mirëmbajtja e bazës së të dhënave për dokumentimin e krimeve dhe të dëmeve të luftës dhe mbledhja nga institucionet publike dhe nga qytetarët e të dhënave për dëmet e luftës.

Autoritetet e Kosovës nuk kanë arritur as ta themelonin Komisionin e së Vërtetës dhe Pajtimin, edhe pse nisma ishte ndërmarrë vite me parë. Kjo nismë ka ngecur dhe deri me përgatitjen e këtij raporti nuk ka të dhëna se a do të vazhdohet me këtë nismë apo do të hiqet dorë nga ajo.

---

<sup>79</sup>Qeveria e Republikës së Kroacisë, Zyra e përfaqësuesit të Republikës së Kroacisë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, analiza e rastit Sanader kundër Republikës së Kroacisë, e qasshme në: <https://uredzastupnika.gov.hr/UserDocsImages//dokumenti/Analize%20presuda%20i%20odluka//Sanader%20%20analiza%20presude.pdf>

<sup>80</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, rasti Pozder kundër Kroacisë, e qasshme në: [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-214762"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

Në fushën e së **drejtës në reparacione**, shteti i Kosovës ka bërë progres të theksuar, sidomos në ofrimin e reparacioneve materiale për viktimat e krimeve të luftës, për shumicën e kategorive, dhe kjo është për t'u çmuar. Megjithatë, duhet t'i bëjë disa amendamente në mënyrë që të ketë një përfshirje më të mirë. Rregullimi me ligje dhe me rregullore i fushës së reparacioneve simbolike dhe memorialeve lë shumë për të dëshiruar. Ngritja e memorialeve që u kushtohen viktimave të luftës të viteve 1998-1999 duhet të rregullohet me një ligj të posaçëm, por në të njëjtën kohë duhet të fuqizohet edhe agjencia për memorialet.

Nuk është punuar mjaftueshëm në shënjimimin e hapësirave publike dhe jopublike, ku ka pasur shkelje masive të të drejtave të njeriut dhe krime të luftës. Edhe pse ka pasur nisma shumë të mira nga ana e shoqërisë civile, pak nga ato nisma janë përkrahur dhe institucionalizuar. Është e papranueshme që shteti i Kosovës ende nuk e ka krijuar në muze, i cili i kushtohet luftës dhe viktimave civile të saj.

Në zbatimin e reformave institucionale, si **garanci e mospërsëritjes**, institucionet e Kosovës kanë bërë shumë dhe shumica prej tyre janë zbatuar në tërësi dhe në mënyrën më të mirë. Për disa nga elementet e reformave institucionale, siç janë reformat strukturore dhe vettingu, nuk ka pasur nevojë, sepse institucionet e sigurisë janë ndërtuar nga fillimi. Çarmatimi, demobilizimi dhe riintegrimi i pjesëtarëve të UÇK-së janë zbatuar në tërësi, ndërsa transformimin i kornizave ligjore është bërë duke i adoptuar të gjitha instrumentet dhe marrëveshjet ndërkombëtare në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ka ngecje në hartimin e programeve trajnuese dhe edukuese për zyrtarë civilë, në mënyrë që të jenë të përditësuar me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

## **Rekomandimet**

Në mënyrë që shteti i Kosovës t'i zbatojë në tërësi dhe me efikasitet mekanizmat e Drejtësisë Tranzicionale, duhet në mënyrë më proaktive dhe të vendosur të hartojë politika dhe strategji dhe t'i zbatojë ato me veprime konkrete. Rekomandimet në vijim ofrojnë sugjerime për zgjidhje të mundshëm, të cilat do të kontribuojnë në efikasitetin e mekanizmave ekzistues dhe krijimin e politikave dhe mekanizmave të rinj në fushën e Drejtësisë Tranzicionale.

Prandaj Avokati i Popullit i

## **REKOMANDON**

### **Presidencës së Republikës së Kosovës:**

- Të angazhohet në krijimin e një komisioni gjithëpërfshirës që kontribuon në arritjen e paqes dhe të vërtetës, duke marrë parasysh nevojat e të gjitha kategorive të viktimave, pavarësisht përkatësisë etnike ose fetare, e i cili do ta hartojë narrativin zyrtar, të saktë dhe gjithëpërfshirës mbi krimet dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut, të ndodhura gjatë luftës në Kosovë.

### **Kuvendit të Republikës së Kosovës:**

- Të shtohen kapacitetet dhe të mbështetet Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në mënyrë që t'i marrë nën menaxhim të gjitha përmendoret dhe memorialet ekzistuese që kanë të bëjnë me luftën 1998-1999.

### **Qeverisë së Republikës së Kosovës:**

- Të ndërmarrë veprime në mënyrë që të mundësohet zbatimi i Strategjisë për Krime Luftë, e hartuar nga ana e Këshillit Prokurorial dhe nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Departamenti për Krime Luftë, në drejtim të nënshkrimit të protokolleve të bashkëpunimit mes Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, në ndjekjen penale të të dyshuarve për krime luftë. Kjo mund të bëhet përmes insistimit që në marrëveshjen finale mes Kosovës dhe Serbisë të përfshihet edhe ky bashkëpunim mes prokurorive.
- Të kujdeset që Instituti i ri për Krimet e Kryera Gjatë Luftës të mbetet një institucion i pavarur dhe pa ndikime politike. I njëjti duhet të fuqizohet edhe me përkrahje financiare dhe me burime njerëzore.
- Ta themelojë muzeun e luftës, i cili do t'i kishte në fokus viktimat civile të luftës.
- Të sponsorizojë një ligj i cili do ta rregullonte deri në detaje ngritjen e memorialeve, shënjimin dhe rregullimin e hapësirave publike dhe private ku kanë ndodhur shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe krimet e luftës.

### **Ministrisë së Drejtësisë:**

- Të përshpejtohet hartimi i Strategjisë Kombëtare për Drejtësi Tranzicionale dhe grupi punues për hartimin e kësaj strategjie të ndihmohet edhe me angazhimin e ekspertëve ndërkombëtarë. Është jetike që Strategjia t'u paraprijë dhe bashkërendojë nismat e tjera të Drejtësisë Tranzicionale.

### **Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit:**

- Memorialet, në formë të ekspozitave fizike apo online, të krijuara nga shoqëria civile nga apo individë, duhet të vlerësohen dhe nëse i plotësojnë kushtet, duhet të institucionalizohen dhe të behën pjesë e muzeve apo të galerive.

### **Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Zyrës së Kryeministrit/Zyrës për Qeverisje të Mirë:**

- Të hartojnë një program të specializuar të edukimit për zyrtarët publikë, të cilët punojnë me palë, veçanërisht me viktimat dhe familjet e tyre, mbi mekanizmat dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe mbi parandalimin e diskriminimit.

### **Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës:**

- Ta plotësojë dhe ta komplotojë regjistrin online interaktiv me shënime mbi ngjarjet që shënojnë memorialet e ngritura.

### **Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur**

- Të ndërmerë veprime konkrete për zbardhjen e identitetit të rreth 300 mberjeve mortore që gjenden në morgun e Institutit të Mjekësisë Ligjore. Kjo mund të realizohet duke bërë evidentimin dhe rishikimin e të gjitha rasteve kur personat e zhdukur janë identifikuar në mënyrë tradicionale. Kështu mund të zbulohen identifikimet e mundshme të gabuara në të kaluarën dhe përmirësimi i këtyre gabimeve përmes procesit të ADN-së.

### **Akademisë së Drejtësisë:**

- Të organizojë trajnime të rregullta për prokurorë të Departamentit për Krime Lufte të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës; për bashkëpunëtorët profesionalë, por edhe për pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të cilët hetojnë krimet e luftës.

### **Këshillit Gjyqësor të Kosovës:**


- Të iniciojë krijimin e një baze të dhënash (databazë) qendrore ku do të arkivoheshin të gjitha dokumentet gjyqësore nga gjykimet për krime lufte të zhvilluara në Kosovë.

### **Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës:**

- Të vendoset bashkëpunimi me Mekanizmin Rezidual për Tribunalet Ndërkombëtare, në mënyrë që të mundësohet marrja e arkivit nga ky Tribunal, materialet nga pesë lëndët për krimet në Kosovë, që janë proceduar në këtë gjykatë. Ky dokumentacion do t'i ndihmonte shumë prokurorët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës në proceset e ardhshme për krime lufte, por do t'i ndihmonte edhe institucionet e tjera në gjetjen e së vërtetës, siç është Instituti për Krimet e Kryera Gjatë Luftës, si dhe Komisioni i së Vërtetës, nëse krijohet.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj") dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatit e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit triidhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

  
Naim Qelaj  
Avokat i Popullit